



DRITA ISLAME

Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / Çmimi: 250 Lekë / www.dritaislame.al

Viti XXXV / Nr. 01 / Janar 2026



Ramazani
Ftesë e Zotit për të dashurit e Tij



“DRITA ISLAME”

**Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë**

www.dritaislame.al

DREJTOR

Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR

Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA

Erzen Carja

KONTAKT:

Tel/fax +355 68 87 71 655

E-mail: mehmet.disha@kmsb.al

Viti XXXV i botimit

Nr. 01 (511)


Janar, 2026


ISSN 2226-7115

*Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen, nuk
paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.*



www.dritaislame.al





editorial

04 Ramazani Ftesë e Zotit për të dashurit e Tij
Editorial nga Hafiz Sabri Koçi

në fokus

06 Në përkujtim të 35 vjetorit të rihapjes së xhamisë
“Et’hem Beu” / Dorian Demetja

08 Fillade shpirtërore në pritje të Ramazanit
Mehmet Disha

lajme / aktivitete

10 01-Çelet edicioni i pestë i konkursit “Urtësitë e
traditës Profetike”
02-35-vjetori i rihapjes së xhamisë së Et’hem Beut
03-Mbyllet kursi fetar një vjeçar i Myftinisë Fier
04-Zhvillohet konferenca ndërkombëtare e 36-të e
Këshillit të Lartë për Çështjet Islame

refleksione

14 Pozitivizmi dhe feja/ Abdullah Bulku

çështje fetare

18 Agjërimi, një nga shtyllat e adhurimit në Islam
Elton Karaj

familja

20 Koha kalon, fëmijët rriten
Aisa Koklçi

horizonti i besimit

22 Le ta presim Ramazanin si të ishte i fundit
Prim.Dr.Med.sc. Ali f. Iljazi

24 Suneti i pastër i Muhamedit a.s., burim i pastër për
arsimin, kulturën dhe civilizimin islam / Xhemal Balla

28 Reflektime udhëtarësh nga viti në vit
Leonard Çela

30 Merjemi - Zonja e ndershme
Kudret S. Hoxha

32 Njeriu i shpresës, i mirësisë, i dashurisë për jetën
dhe njeriun

bota shpirtërore


34 Pyetje & përgjigje rreth agjërit
Redaksia

hapësirë feminare

36 Këshilla të vlefshme për çdo fëmijë
Hapësire Feminare

këndi i poezisë

38 Hana e Ramazanit
Ferit Vokopola



Ramazani

Ftesë e Zotit për të dashurit e Tij



Në këtë muaj të madhërueshëm, i madhi Zot i fton të gjithë besimtarët me bujarinë më të madhe: Ejani te dashuria Ime, ejani të respektoni urdhrat e Mi, ejani te këto detyra të shenjta, që janë gjallëri e vërtetë për ju.

Pranoni dhe repsekonti këtë thirrje të madhërueshme, sado faje që të keni bërë, Allahu është i Mëshirshëm, është i Dashur. E këtë që ta kemi të qartë, sepse askush nuk ia imponoi që të na nxirrte në këtë jetë, kjo ishte vetëm dëshira e Tij. Nuk u mjaftua duke na bërë krijesën më e përkryer, por na nderoi edhe në pikëpamje të veshjes, të ushqimit dhe të jetuarit, kështu që dallohemi nga të gjitha krijesat e tjera. Allahu me madhërinë e Vet vuri në

dispozicion gjithçka për ne, çdo gjë që ekziston në rruzullin tokësor dhe në planetet e tjera është në dispozicionin tonë.

Prandaj thërret: O gjynahqarë, o mëkatarë, drejtohuni tek Unë, se ju strehoj me bujarinë dhe dhembshurinë Time, përmirësoni jetën tuaj, përmirësoni sjelljet tuaja, gjendjen tuaj morale, pajisuni me cilësitë më të larta njerëzore, sepse ashtu i ka hije një njeriu.

Ky muaj i madhërueshëm ka vlera të jashtëzakonshme. Na miqëson me Allahun. Gjatë 12 muajve, sa herë na ka rënë në mend për Të? Ndoshta asnjëherë.

Filozofia islame thotë që ne të besojmë dhe të

adhurojmë fuqinë absolute, Krijuesin e gjithçkaje, Zotin. Ngado që të vështrojmë, shohim mjeshtërinë e Tij, çdo gjë e ka krijuar sipas dëshirës së Tij. Na thërret që ta adhurojmë Atë, ta dëshmojmë me gojë dashurinë për Të, qenien e Tij: La ilahe il'Ilal'Allah".

Nuk adhurohet kush tjetër, nuk është kush i pavdekshëm dhe i përhershëm përveç Atij; nuk mund të ndërhyjë kush në punët e Tij, gjithmonë do të jetë i përsosur. Ai është që ngjall e vdes e në mesin e krijesave Ai zgjedh kë të dojë. Prandaj e lavdërojmë gjithmonë, se ne, njerëzit, na ka zgjedhur mbi të gjitha krijesat.

Ky muaj i fton njerëzit që të pendohen për të gjitha gabimet që kanë bërë, qofshin personale, në familje apo në farefis ose në mbarë shoqërinë. E për këtë kërkojmë falje me pendim të plotë, sepse nuk është e largët dita që ne do t'i shkojmë të madhit Zot dhe do të japim llogari për të gjithë veprimtarinë që kemi kryer gjatë jetës.

Gjithashtu ky muaj është muaji i mëshirës së madhe (i rahmetit). Ky është një muaj gjatë të cilit Allahu me madhërinë e Vet i mbush me mëshirë, me dhembshuri, me dashuri zemrat e njerëzve, zemrat e atyre që i përkushtohen të madhit Zot.

Në këto net Allahu bën edhe një mirësi tjetër, e ndërpret aktivitetin e djallit. Djalli në çdo rast ndërhyr në epshet e njeriut dhe e nxit, e detyron që të mos njohë asgjë, veç vetveten. E në këtë mënyrë ai nuk dallohet nga kafsha me veprimet që kryen, duke bërë veprime të parregullta e padrejtësi të ndryshme.

Nga të gjitha këto mirësi të Allahut, i gjithë muaji Ramazan, i gjithë agjërimi na duket sikur të ishte një ditë e vetme.

Gjatë këtij muaji për një periudhë të caktuar kohe ndërpriten ushqimet, marrëdhëniet intime bashkëshortore, kurse nga iftari e deri në syfyr njeriu përsëri është i lejuar që të zhvillojë veprimtarinë normale të jetës, duke i kryer të gjitha veprimet si në çdo ditë tjetër.

Asgjërimi është një provë sa ndien për Zotin, a e do me të vërtetë, apo e do për interes.

Cilido që e ndien në zemër të vet duhet ta dashurojë Allahun, ta respektojë dhe ta kujtojë. Kjo dashuri është fshehur thellë në zemër dhe tregohet përmes veprave të mira dhe gjuhës që e përmend duke thënë: Ti je, o Zot, nuk është kush tjetër, Ti na mëshiron, na ndihmon, na lehtëson vuajtjet dhe mjerimet, na zbardh faqen, kur të dalim në botën tjetër para drejtësisë Tënde.

Krijuesi i gjithësisë është Zoti. Ai nuk ka kërkuar ndihmën e askujt, nuk ka trashëgimtarë, bij e bija. Allahu është i përhershëm dhe i pavdekshëm.

Gjithashtu besimtarët myslimanë në këtë muaj zhvishen nga vetitë e dobëta, ruajnë gjuhën nga gënjeshtria, nga shpifja, nga bartja e fjalëve, nuk dalin dëshmitarë në rrenë, nuk përgojnë tjetrin.

Të përpiqemi me të gjitha mënyrat që të ndihmojmë tjetrin, ta ndihmojmë në punë, me ushqime e me veshmbathje, ta ndihmojmë me fjalë të mira, sepse ky

është muaji i bujarisë. Allahu kërkon bujari nga ne, mos të na dhimbset pasuria, t'i gjendemi te porta atij që nuk i troket askush, t'i dërgojmë diçka, një dhuratë, duke e gëzuar atë dhe familjen e tij.

Në këtë mënyrë e ruajmë të pastër shpirtin dhe të pastër e dorëzojmë. Ne nuk e kemi parë kur na ka ardhur dhe nuk do ta shohim kur do të na dalë. E sheh vetëm Ai që e ka krijuar, vetëm Ai gjendet pranë nesh në kohën që japim shpirt. Ka mëshirë e dhembshuri, na i lehtëson vuajtjet e na shoqëron në botën tjetër, sepse asgjë nuk humbet (edhe ateistët thonë se gjithçka lind, rritet, zhvillohet, vdes, transformohet, edhe pse nuk kanë besuar asgjë).

Pra, Allahu në këtë muaj pranon lutjet tona, na i fal të metat tona dhe dëshiron që ne vërtet të kthehemi në rrugë të mbarë.

Agjërimi nuk është detyrë vetëm për myslimanët, por për mbarë njerëzimin dhe e ka zanafillën që nga njeriu i parë, nga babai i njerëzimit, Ademi a.s. Fjala Ramad(z)an do të thotë përvëlues. Ramazani sipas kalendarit hënor xhiron në të gjitha stinët dhe ka raste që vjen edhe në qershor, korrik e kështu të përvëlton mushkëritë nga vapa, pra në njëfarë mënyre të përvëlton.

Në një drejtim tjetër, në një kuptim tjetër, do të thotë se, ky muaj i madhërueshëm i asgjëson mëkatet e njerëzimit. Të gjithë ata njerëz që e pranojnë në mendjen e tyre dhe e respektojnë të madhin Zot, janë të pastruar.

Agjërimi ka vlera të mëdha higjienike, e ndihmon organizmin e njeriut. Mjekësia botërore e vlerëson shumë rolin e agjërit, i cili mund të jetë i pjesshëm, për disa ushqime në veçanti dhe deri tek agjërimi i plotë që mbajmë ne. Ai bën një pastrim të përgjithshëm në organizëm, pastron gjakun, pastron mbetjet në stomak, në zorrë etj., domethënë merr një ripërtëritje, rifreskim.


Në anën shpirtërore të zbut mendjen e shpirtin. Njeriu, duke pritur me padurim iftarin, mendon për ata që nuk e kanë vazhdimisht kafshatën e bukës. Gjatë luftës së Bosnjes unë u ndodha në Zagreb. Atje besimtarët myslimanë ishin të agjërueshëm me qëllim që të kursenin ushqimin, t'u dërgonin jetimëve të Bosnjes për t'i ndihmuar. Pra agjërimi të mëson, të edukon se si t'i ndihmosh të tjerët, nevojtarët.

Zemra përmirësohet kur kujton Allahun dhe kur zbaton ligjet e urdhëruara prej Tij, duke penguar aktivitetin e epsheve të njeriut. Epshet e dëmtojnë njeriun, e nxisin të kryejë veprimet më të dobëta. Prandaj, Profeti a.s. u ka bërë thirrje: "O të rinj e të reja, sa më shpejt martohuni, që të lidhni martesën me njëri-tjetrin e t'i shuani epshet tuaja brenda normave njerëzore e jo në formë ilegale". Agjërimi për të rinjtë e të rejtë është një mjet për të luftuar epshet.

Të mundohemi që gjatë këtij muaji mendja jonë të punojë vetëm për Zotin, vetëm për të mira. Këmba jonë të mos shkelë ku nuk duhet, veshi ynë, goja dhe i gjithë organizmi duhet të veprojë sipas dëshirës së Zotit duke mos dalë nga rruga e Tij.

Zoti na mëshiroftë të gjithëve

Në përkujtim të 35 vjetorit të rihapjes së xhamisë “Et’hem Beu”



Këtë 18 janar përkujtojmë 35 vjetorin e rihapjes së xhamisë "Et'hem Beu" në Tiranë, e cila i kishte mbyllur dyert e saj 23 vite më parë, për shkak të ndalimit të besimit në Shqipëri nga sistemi komunist. Me këtë rast u bë me një ceremoni madhështore, në të cilën morën pjesë mijëra besimtarë dhe qytetarë të Tiranës. Ajo ishte dita kur emocionet, entuziazmi shpirtëror dhe shpërthimi i ndjenjave për qytetarët e Tiranës, kishin arritur kulmin. Njerëzit të përmalluar, dëgjonin me vëmendje e kureshtje, qanin e çmалleshin me xhaminë.

Shumë prej xhamive të Tiranës gjatë sistemit komunist qenë shndërruar ose rrënuar dhe trualli i tyre ishte zëvendësuar me ngrehina të tjera, por, për fatin e mirë, xhamia "Ethem Beu", e cila bashkë me kullën e sahatit ishin bërë simbol i kryeqytetit në çdo imazh fotografie apo pikturë që përfaqësonte Tiranën, arriti t'i shpëtonte tiranisë së komunizmit. Ishte prej begatëve të Zotit, që kjo xhami qëndroi në këmbë gjersa u rihap sërish për t'iu rikthyer zemrave të besimtarëve.

Ceremonia filloi me thirrjen e ezanit të parë nga Fadil Subashi. Ishin Xhavit e Iljaz Alimehmeti, Ramazan Rusheku, Ibrahim Balla, Mehmet Sinella, etj., disa nga nismëtarët kryesorë myslimanë, të cilët hapën në Tiranë dyert e xhamisë "Et'hem Beu" për besimtarët. Përmbytja e fjalimeve të tyre në xhami, mund të përmbledhet në thirrjen e njerëzimit për besim, paqe, dashuri, harmoni, mirëkuptim, bashkëpunim, miqësi e vëllazërim midis njerëzve pa dallim.

Atë të premte janari, për qytetarët e Tiranës kishte zbardhur një ditë e madhe, që do të ringjallte shpresën për ditë më të mira. Në fytyrat e pjesëmarrësve lexohej gëzimi për këtë ngjarje të madhe, që shënonte rikthimin e besimit në jetën e tyre, pas një diktature të shfrenuar dhe një regjimi të ashpër komunist, i cili u përpoq të çrrënjosë fenë dhe besimin, por që kurrë nuk ia doli mbanë. Edhe pse përjetuan 23 vjet ngricë shpirtërore, shumë qytetarë të Tiranës, kishin ruajtur brenda tyre dashurinë për Zotin, kishin ruajtur ndezur brenda shpirtit të tyre një zjarr, që nuk lejoi ngricën komuniste të ftohte besimin e tyre në Zot. Kjo gjë, u vërtetua pikërisht në këtë ditë.

Lidhur me fillimet e aktivitetit fetar në qytetin e Tiranës z. Islam Kadesha shkruan: "Merekomandimin e z. Sinan Tafaj, shkuam në shtëpi të z. Faik Kasollja, i cili na mirëpriti dhe lamë takimet e para në lulishten pranë Kuvendit Popullor. Në takimin e dytë, z. Faik solli kolegë dhe miq të tjerë, zotërinjtë Ramazan Rysheku, Ibrahim Balla, Xhavid Alimehmeti, Selim Stafa e Mehmet Sinella. Gjatë dhjetorit 1990, të ngarkuar me plot ngjarje, u zhvilluan takime pas takimesh. Në fillim të vitit 1991, z. Iljaz Alimehmeti

vuri në dispozicion banesën e vet për të zhvilluar takimet. Në ato ditë, një kontribut ka dhënë edhe një palestinez me emrin Zyher Naim. Në takimet e fillim vitit 1991, morën pjesë edhe besimtarë të tjerë si dr. Shefqet Ndroqi, dr. Qazim Bakalli, Bardhyl Fico, Sali Mëniku, Kujtim Gjinishi, Shyqyri Bylyku, etj. Pas shumë takimesh, arritëm në përfundimin që të konkretizohet e gjithë puna me marrjen e xhamisë "Et'hem Beu", detyrë që iu ngarkua Islam Kadeshës, Iljaz Alimehmetit, Ramazan Ryshekut dhe Ibrahim Ballës. Me gjithë pengesat e kryesisë së pushtetit të atëhershëm, drejtori i Institutit të Monumenteve të Kulturës, z. Emin Riza, u tregua i gatshëm në dhënien e xhamisë më 15.01.1991. Me datë 16.01.1991 komisioni provizor, i përbërë prej 7-8 vetash, pasi mori në posedim xhaminë e "Et'hem Beut", mori vendim që me datë 18.01.1991 të deklaronte rihapjen e veprimtarisë fetare. Në mbledhjen e fundit të komisionit u vendos të mbahej fjala e rastit nga z. Ibrahim Balla, të bëhej drejtimi i mevludit nga z. Ramazan Rysheku dhe të bëhej falja e parë e namazit të ditës së premte. Kjo ka qenë ceremonia e parë, tepër madhështore, në të cilën morën pjesë rreth mijëra qytetarë, nga të cilët u mbulua i gjithë sheshi "Skënderbej". Ka qenë një ceremoni tepër prekëse, sepse për gati 50 vjet nuk ishte parë ndonjëherë një pjesëmarrje e tillë. Data 18 janar 1991, është dita e parë që zyrtarisht konsiderohet rihapja e veprimtarisë fetare në Tiranë."

Ndërsa në një bisedë, ish drejtori dhe mësuesi i Medresës së Tiranës, z. Xhemal Balla, lidhur me këtë ditë, thotë: "Në Tiranë, mbështetja e parë ishte e z. Ibrahim Balla, ish-drejtor i përgjithshëm i vakfit në Komunitetin Mysliman Shqiptar deri në vitin 1967, kur shteti e mbylli fenë me ligj. Ibrahim Balla ishte i fundit që dorëzoi arkivin e Komunitetit Mysliman, si dhe çelësin e xhamisë së 'Et'hem Beut' në Komitetin Ekzekutiv të Tiranës, sot Bashkia e Tiranës. Hapi i parë u hodh në mbajtjen e një ceremonie fetare (mevlud) në xhaminë e 'Et'hem Beut' më 18 janar 1991. Ishte Ibrahim Balla ai që kishte dokumentin e dorëzimit të çelësit në Komitetin Ekzekutiv të Tiranës më parë, i cili e rimori çelësin me vështirësi dhe me rezistencë nga Bashkia. Ceremonia kaloi në mënyrë të përsosur, e ndjekur nga mijëra besimtarë në sheshin 'Skënderbej'. Pas ceremonisë së mevludit, zotërinjtë Ibrahim Balla, Ramazan Rusheku e të tjerë, u drejtuan drejt 15-katëshit (Hotel Tirana). Këtu bëhet mbledhja e parë zyrtare bashkë me z. Bardhyl Fico."

Vlerësim dhe mirënjohje për të gjithë ata njerëz, që me zell e përkushtim kontribuan në skalitjen e datës 18 Janar 1991 në kujtesën historike të Tiranës, si dita e rihapjes së xhamisë "Ethem Beu".

FLLADE SHPIRTËRORE NË PRITJE TË RAMAZANIT

Kohët kanë veçantinë e tyre dhe njerëzit i vlerësojnë ato në bazë të përjetimeve dhe të ndienjave që asociohen me to. Është një shtytje e brendshme që i nxit njerëzit të krijojnë ndërlodhje të ngushta më ditët, muajt a vitet që kalojnë, e kështu ata herë veçojnë ditëlindjet, gëzimet e ndryshme, përrurimet e kujtimeve të ndryshme, ngjarje e ndodhi që kanë patur gëzime të veçanta në data të caktuara. Ne si besimtarë gëzojmë për ato kohë që Zoti i ka veçuar për ne. Sigurisht çdo çast është i vyer dhe unik, sidomos nëse zemra është e afërt me Zotin në aspektin e adhurimit dhe njohjes. Çdo orë, çdo ditë e çdo natë pavarësisht muajit apo vitit, është pa dyshim një mundësi për të gjetur strehën e duhur që të rinovosh edhe një herë lidhjen tëndë shpirtërore me Krijuesin e Gjithësisë, i Cili, me Mëshirën e Tij të Pakufishme, dërgon fllade të veçanta kohore brenda jetëve tona që dhe këtë jetë, e kemi dhuratë prej Tij.

Kështu, brenda muajve, Allahu xh.xh ka veçuar disa muaj duke u dhënë begati me veçantinë e Tij të Shenjtë, duke i përfutur kështu kohës një "kudsiyet", ashtu siç Ai xh.xh ka bërë edhe me disa vende siç është Qabja në Mekë, Mesxhidi Aksa në Kuds-Jeruzalem, apo edhe Xhamia e Profetit Muhamed a.s. në Medinen në Ndritshme.

Ramazani është muaji më i veçantë i të gjithë vitit dhe kësaj here në sërish, me lejen e Zotit, po i afrohem me mall e ngashërim. Në fakt koha është prej Zotit dhe grishja e vërtetët e mallit është ajo e besimtarit për Krijuesin, gjë që në Razaman, ky mall gjen mëshirë e falje si asnjëherë tjetër.

Me fillimin e Ramazanit rinovohen edhe një herë mendimet, frymëzohen ndjenjat, ndërsa mëshira në frekuenca të shumëllojshme shkon e bashkohet ku me ankthin e ku me shpresën, bashkohet e thellohet në shpirt. Po, me ardhjen e tij ngrihen të gjitha pengesat e arritjes për tek Allahu, të gjitha paudhësitë shkatërrohen.

Për shpirtat që ndiejnë përherë etjen për mëshirë, Ramazani është si shiu që mbërrin në zemër të tokës, vadit gjithë qenien, nga koka te këmbët, ujit ndërgjegjet që kanë filluar të thahen, zbret deri në thellësitë e ndjenjave dhe e kthen vetëdijen njerëzore në një pllajë të gjelbëruar. Aq sa të gjithë këta shpirta që përjetësohen me ngjyrimin e minutave të kësaj pjese të bekuar të kohës zgjohen ndaj thellësive të magjishme të ekzistencës dhe s'duan të ndahen më prej kësaj klime plot hijeshi.

Në këtë mënyrë, këta njerëz të përkohshëm arrijnë në gradën e qenieve të përjetshme, ndërsa çdo sjellje e tyre e programuar sipas shpirtit të tyre të adhurimit, arrin vlera ceremonish parajsore.

Gati çdo natë në Ramazan është shumë më e thellë se netët e tjera dhe me dimensione të përtejme; ndërsa ditët me atë maturinë dhe ngjyrat goditëse ndjehen si një atmosferë sinjifikuese e vullnetit dhe durimit.

Shpirtat e agjërueshëm, sikur përgatiten çdo natë për një takim të ri, të emocionuar deri në ngazëllim, të sjellshëm në masë dhe të edukuar deri në habi, trokasin

në dyert e mëshirës dhe shpresës. Në fytyrat e tyre shfaqen njëherësh modestia me seriozitetin, siguria me brengën, sundon të qenit që e mënjanon bindshëm të dukurit. Zemrat u rrahin me dashuri, para së gjithash për të Dashurin e vetëm të zemrës së tyre, e më pas, po për hir të Tij, për çka ai ka krijuar.

Sytë plot magji e të mbështeturve me gjithë zemër tek Allahu, pasqyrojnë një sërë thellësish prej së përtejmes dhe gati të gjithë këta sy shkëlqejnë me dritën e një bote të panjohur.

Kush të dojë, edhe në Ramazan madje, le të ulet e të ngrihet me smirë e urrejtje, kush të dojë të turbullohet përballë të vërtetave të besimit dhe Islamit, kush të dojë le të mallkojë dritën, kush të dojë t'i shpallë luftë mirënjohjes, tolerancës; ndërsa neve Ramazani, me gjithë dritën dhe forcën magjepsëse që zotëron, na pëshpërit me zërin shpresëdhënës pasuritë tona shpirtërore, traditën tonë të hershme; na pëshpërit dhe shpirtat tanë të uritur i ngop me sofrat e begata, ndërsa përballë shpirtave të errët, qëndron i hapur, dhe duke i shkrirë urrejtjet e armiqësitë vazhdon të na freskojë me flladin e Xhenetit.

Mbarë myslimanët, të rinj e të vjetër, gra e burra, të pasur e të varfër, të shëndetshëm e të sëmurë, drejtues e të drejtuar, nëpunës e tregtarë, vijnë e bashkohen në klimën zbutëse, formuese e të magjishme të Ramazanit... e me një përzemërsi, pastërti, ngrohtësi ndajnë së bashku një lumturi që vetëm krijesat qiellore e njohin. Madje, në të shumtën e rasteve, ai ka një ndikim të pabesueshëm edhe mbi masat e njerëzve që duken të paaftë, të mjerë e të shkrëtë. Është e pamundur të mbetesh indiferent përballë Ramazanit që përfshin çdo gjë!

Ramazani, sidomos zemrat e hapura ndaj pafundësisë, i magjeps aq shumë, i ndikon aq thellë saqë vetëm atë dëgjojnë, atë mendojnë dhe atë ëndërrojnë!

Për të vëmendshmit e këtij muaji, iftares përbushen me ndjenjën e adhurimit dhe thujse bashkëngjiten me teravitë; syfyret ndërthuren me namazin e natës dhe marrin pjesë prej afrimit me Mëshirëplotin. Rrugët mbushen me udhëtarët e xhamive, faltoret oshtijnë si Qabeja me tekbiere; rrugët, pazaret sikur kthehen në faltore; dhe faltorja vete e shndërrohet në Qabe.

Çdo zë, çdo lëvizje, çdo hap dhe çdo veprimtari në këtë muaj, na kujton Ramazanin në mënyrën e vet. Ndërsa ne mundohemi ta përjetojmë atë thellë në gjokset tona, ai, me momentet më të zjarra na dhuron dashuri, përkushtim dhe emocion, duke i ofruar shpresë e vullnet etjes së zemrës sonë, ai i rikthen gëzimin syve të përplotur dhe buzëqeshjen fytyrave të brengosura.

Për këtë, ne nuk duam aspak që Ramazani të largohet; ne nuk duam por, sikurse çdo gjë që vjen duhet të ikë kur t'i vijë koha, edhe ai, si një i ftuar gëzimsjellës vjen, e pasi qëndron njëfarë kohe, largohet...dhe pas tij, vjen Bajrami, si kurorëzuesi i vetëm i gjithë pasurive të këtij muaji magjepsës.

01 ÇELET EDICIONI I PESTË I KONKURSIONIT "URTËSITË E TRADITËS PROFETIKE"



Kolegji Universitar "Bedër", në bashkëpunim me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, zhvilluan ceremoninë hapëse të fazes së pestë të konkursit ndërkombëtar "Urtësitë e Traditës Profetike".

Në këtë ceremoni, të zhvilluar në ambientet e "Bedër", ishin të pranishëm Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, Rektori i KU "Bedër", Prof. Dr. Gjergji Sinani, përfaqësues të tjerë të lartë të të dy institucioneve, si dhe një numër i konsiderueshëm studentësh nga vende të ndryshme.

Ceremonia nisi me leximin e disa ajeteve Kuranore, për të vijuar më pas me fjalën hapëse të Rektorit Sinani, i cili u uroi mirëseardhjen të pranishmëve dhe theksoi rolin e veçantë që "Bedër" ka në angazhimin e të rinjve në projekte kërkimore, si fetare po ashtu edhe akademike, sociale dhe kulturore.

Ndërsa Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, fillimisht përshëndeti nismën dhe historinë e saj tashmë pesëvjeçare, duke shprehur mbështetjen e tij dhe të institucionit që ai drejton për vazhdimësinë e saj. Ai e mbylli fjalën e tij duke ju uruar suksese të gjithë pjesëmarrësve të këtij edicioni.

Ceremonia vijoi më tej me një referim të shkurtër nga Dr. Jamal Alsafarti, Shef i Departamentit të Shkencave Islame në "Bedër", i cili vuri në dukje rëndësinë thelbësore të sunnetit profetik si udhërrëfyes i jetës së besimtarit, duke theksuar rolin e tij në formimin shpirtëror, etik dhe praktik të individit në përditshmëri.



02 35-VJETORI I RIHAPJES SË XHAMISË SË ET'HEM BEUT



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë organizoi një ceremoni përkujtimore me rastin e 35-vjetorit të rihapjes së Xhamisë së Et'hem Beut, një nga simbolet më të rëndësishme të rikthimit të lirisë së besimit në Shqipëri. Programi nisi me lexim Kurani nga Hafiz Enes Hyka. Më pas, imami i Xhamisë së Et'hem Beut, Elton Karaj hapi programin kushtuar kësaj date historike.

Në vijim, u shfaq një video e shkurtër përmbledhëse mbi ngjarjen e rihapjes së xhamisë dhe kontekstin historik të asaj periudhe, duke rikujtuar momentet kyçe të rikthimit të besimit fetar pas dekadash ndalimi.

Më pas, fjalën e mori Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili vlerësoi rëndësinë e kësaj ngjarjeje për historinë e fesë islame në vend dhe rolin e Xhamisë së Et'hem Beut si simbol i lirisë së besimit.

Në kuadër të kësaj ceremonie, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë ndau certifikata vlerësimi në shenjë nderimi dhe mirënjohjeje për kontributin e dhënë në shërbim të Xhamisë së Et'hem Beut dhe ringjalljen e jetës fetare pas rihapjes së saj. (Pas vdekjes) u vlerësuan:

- Z. Hasan Qytyku, imam i Xhamisë së Et'hem Beut;
- H. Shaban Saliq, imam i Xhamisë së Et'hem Beut dhe Myfti i Tiranës;
- Z. Fadil Subashi, muezini që thirri për herë të parë ezanin në rihapjen e xhamisë më 18 janar 1991 dhe që shërbeu për shumë vite në këtë xhami. Gjithashtu, u vlerësuan me certifikata mirënjohjeje personalitete që i përkasin brezit të maturantëve të Medresesë së Tiranës.



02 MBYLLET KURSI FETAR NJË VJEÇAR I MYFTINISË FIER



Zyra e Gruas pranë Myftinisë së Fierit, përgjatë gjithë vitit që lamë pas, zhvilloi kursin fetar për fëmijë të grupmoshave të ndryshme, ku u trajtuan lëndë të tilla, si: Kuran, fik'h, histori dhe njohuri të përgjithshme Islame.

Ditën e djeshme, në ambientet e myftinisë, u zhvillua ceremonia përmbyllëse e këtij kursi, e shoqëruar me ndarjen e çmimeve për fëmijët pjesëmarrës, duke pasqyruar kështu përpjekjet dhe arritjet e tyre gjatë gjithë vitit.

Të pranishëm në këtë program ishin Nënkrjetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, Myftiu i Fierit, z. Mikel Hazizolli, Përgjegjësja e Zyrës së Gruas pranë kësaj myftinie, znj. Bruna Hazizolli, si dhe prindër të shumtë të fëmijëve pjesëmarrës.

Në fjalën e tij hapëse, Myftiu i Fierit u uroi mirëseardhjen të pranishmëve dhe vuri theksin në angazhimin e vazhdueshëm të institucionit që ai drejton, jo vetëm në zhvillimin e jetës fetare, por edhe në edukimin e brezave të rinj, duke e konsideruar këtë mision si një pjesë thelbësore dhe të pandashme të vizionit të Myftinisë.

Nga ana e tij, Nënkrjetari i KMSH-së, z. Taulant Bica, vlerësoi rolin dhe rëndësinë e kurseve fetare të zhvilluara në xhamitë dhe institucionet e Komunitetit Mysliman në mbarë vendin, si jetike në pajisjen e fëmijëve me njohuritë bazë të fesë Islame dhe në formimin e tyre moral e shoqëror. Të pranishmit i përshëndeti gjithashtu edhe Përgjegjësja e Zyrës së Gruas, znj. Bruna Hazizolli, e cila ndau me ta përvojën e saj gjatë menaxhimit të këtij kursi. Në përmbyllje, të gjithë fëmijët u shpërblyen me dhurata motivuese, si nxitje dhe inkurajim.



04 ZHVILLOHET KONFERENCA NDËRKOMBËTARE E 36-TË E KËSHILLIT TË LARTË PËR ÇËSHTJET ISLAME



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, po merr pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë “Profesionet në Islam: Parimet Morale, ndikimi dhe e ardhmja e tyre në epokën e Inteligjencës Artificiale”, e cila organizohet nga Ministria e Vakfeve e Egjiptit, në datat 19-21 janar 2026, me ftesë zyrtare të Ministrit Egjiptian të Vakfeve, z. Usame el-Ez'herij.

Si një ndër krerët fetarë pjesëmarrës, kryetari Spahiu mbajti një kumtesë ku foli rreth temës së profesioneve në periudhën e ndritur të profecisë së Profetit Muhamed (s.a.v.s), nga këndvështrimi i evidentimit dhe klasifikimit të tyre, etikës dhe moralit profesional, si dhe dispozitave juridike islame që lidhen me to.

Gjatë kumtesës së tij, ndër të tjera, z. Spahiu tha: “Profesioni, sipas konceptimit profetik, nuk është thjesht një mjet fitimi, por një funksion qytetëruës dhe një mision etik. Frymëzimi nga ky model përbën një parathënie thelbësore për trajtimin e sfidave bashkëkohore të tregut të punës, rikthimin e vlerës së përsosmërisë dhe produktivitetit, si dhe ndërtimin e një njeriu produktiv e të balancuar që bashkon përsipirtshmërinë me kompetencën”.

Gjatë konferencës në fjalë, kryetari Spahiu po përfaqëson Komunitetin Mysliman të Shqipërisë duke zhvilluar takime me kryetarë komunitetesh myslimane dhe ministra të çështjeve fetare nga shumë vende të botës.



Pozitivizmi dhe feja



Përgjatë historisë njerëzore, në çdo epokë, njerëzimi e ka formësuar jetën shoqërore sipas një botëkuptimi të caktuar mbi realitetin dhe të vërtetën. Edhe pse periudhat dhe realitetet e ndryshme kanë specifikat e saj, epoka moderne do të sillte një ndryshim rrënjësor dhe shkëputje nga e shkuara që nuk kishte ndodhur në qytetërimet e mëhershme. Ndryshmi më i madh dhe thelbësor mes epokës moderne dhe para saj është qasja kundrejt fesë. Në periudhën para modernitetit, feja kishte një rol thelbësor dhe përcaktues në të gjitha shoqëritë në botë. Në shoqëritë tradicionale feja jepte një botëkuptim mbi diturinë, shkencën, artin, politikën, marrëdhëniet njerëzore deri në jetën e përditshme duke qenë një realitet me një rëndësi ekzistenciale për çdo shoqëri. Me ardhjen e iluminizmit në perëndim, feja u shkëput nga shkenca, mendimi dhe kultura duke e humbur vendin e saj në shoqërinë moderne. Kështu moderniteti filloi të ndërtonte ekzistencën e tij nëpërmjet zhvillimit të institucioneve si shteti modern, sistemi ekonomik kapitalist dhe arsimi modern.

Me zhvillimin e modernitetit sipas koncepteve të reja do të ndryshonte qasja mbi entitetet e ndryshme si shkenca, kultura arti duke përfshirë edhe fenë brenda këtij sistemi. Kështu nëse më herët ajo përbënte një autoritet mbi të vërtetën dhe udhëhiqte shoqërinë sipas një botëkuptimi të caktuar, tashmë ajo u bë pjesë përbërëse e këtij sistemi duke çuar në transformimin dhe largimin nga thelbi i saj. Si rrjedhojë feja do të perceptohej si një neurozë, si trillim mendjes njerëzore për tu dhënë kuptim jetës apo dukurive të pashpjegueshme, si një trashëgimi e së shkuarës që reflektohej nënvetëdijen e tij, si një realitet i burgosur brenda ndërgjegjes dhe shpirtërore apo një mënyrë për të sunduar shoqëritë nga elitat ekzistuese. Edhe pse në fillimet e saj dhe me lulëzimin e pozitivizmit feja do të përjashtohej nga jeta njerëzore në mënyra të ndryshme si një formë e prapambetjes, me kalimin e kohës shumë filozofë, duke shpëtuar nga kthetrat empirizmit absolut dhe vetë pozitivizmit do të fillonin të njihnin dhe vlerësonin edhe njëherë vlerën e saj. Por edhe ky botëkuptim formohej mbi paradigma të caktuara filozofike, të pamjaftueshme për të perceptuar dhe përfshirë thelbin e saj. Jashtë këtyre ndikimeve nuk do të shpëtonte as bota islame e cila kishte filluar të imitonte qytetërimin perëndimor në të gjitha dimensionet e saj. Në aspektin intelektual, ndër të tjera kjo do të reflektohej edhe në qasjen moderniste ku të

mahnitur nga qytetërimi modern do të analizonin tekstet fetare, dimensionet psikologjike dhe sociologjike të saj në këndvështrimin modern dhe racionalist duke u shkëputur nga tradita intelektuale dhe shpirtërore e fesë dhe vetë thelbi i saj.

Revolucioni shkencor në perëndim do të niste në shek. XVI-XVII duke refuzuar metafizikën dhe përcaktuar arsyen si burimin kryesor të njohjes do të kulmonte me pozitivizmin në shek. XIX e cila do të bëhej paradigma kryesore e mendimit shkencor në perëndim. Pozitivizmi është një sistem filozofik që e kufizon veten në të dhënat e përvojës, që përjashton spekulimet apriori dhe metafizike, që thekson arritjet e shkencës, dhe thotë se dije e vetme e vërtetë është ajo shkencore që arrihet nga vëzhgimi i fakteve dhe përvoja. Themeluesi i pozitivizmit njihet Auguste Comte. Ai kishte shumë besim tek a ardhmja e shkencës dhe parashihte se shpjegimi shkencor do të shtrinte gjithnjë e më shumë fushën e tij duke përfshirë të gjithë fushën njerëzore. Filozofia e tij e historisë dhe qasja ndaj saj në fakt sendërtohet rreth qëndrimit të tij mbi fenë. Sipas Comtes historia e shkencave ishte biografia e arsyes. Duke e perceptuar filozofinë e historisë në mënyrë lineare ai e ndante atë në tre faza. Periudha e parë është ajo teologjike ku dituria rreth shkencave natyrore është nivelin më të ulët dhe njerëzit i shpjegonin të gjitha ngjarjet nëpërmjet faktorësh teologjikë, domethënë të mbinatyrshëm dhe të lidhur me hyjninë. Kjo periudhë kalon në tre faza në shpjegimin fetar, politeist dhe monoteist. Periudha e dytë e cila do të vazhdonte deri në fundin e mesjetës është ajo metafizike ku feja nga zëvendësohet forca abstrakte apo idetë filozofike. Edhe e fundit është koha e artë ku njerëzimi nëpërmjet metodave shkencore do të kuptojë të gjitha të vërtetat universale dhe zhvillimet shoqërore duke mënjanuar të gjitha burimet njohëse të njeriut përgjatë historisë si feja apo paradigma të ndryshme shkencore. Sipas këtij botëkuptimi ai do të zhvlerësonte rolin e metafizikës duke e bërë atë objekt të shkencës pozitive dhe një epsitemologjie që formësohet rreth të dhënave empirike. Ai do të ishte një nga themeluesit e sociologjisë moderne duke e konceptuar atë si “fizika shoqërore”.

Comte do të shkonte më tej me “misticizmin” e tij duke e perceptuar pozitivizmin bazën e një feje të re që do ta quante si “feja e njerëzimit”. Sipas tij njeriu është e vërteta më e lartë dhe ai përpiqet ta vendosë atë në vendin e Zotit. Parimi kryesor i kësaj feje do të ishte dashuria, themeli rregullsisia

dhe qëllimi i saj progresi. Ashtu sikurse në çdo fe ka dogmë dhe adhurim kjo fe do të ushqej nga filozofia, poezia dhe politika. Kështu Zoti i kësaj feje do të ishte njeriu, engjëj gratë dhe adhurimi do të ishte kundrejt "njerëzimit". Lutja është të angazhohesh në dashuri dhe mendim. Poezia dhe dituria përfaqëson dogmën ndërsa arti shpirtin e adhurimit. Për më tepër ai kishte zhvilluar edhe projektin se si do të përhapej kjo fe e re njëlloj si misonarët fetarë përgjatë historisë.

Duhet thënë se filozofët e këtij e shekulli ishin shumë entuziastë saqë parashikonin se në shek. XX shkenca do të zbulonte të gjithë të vërtetat dhe pyetjet e qenies njerëzore dhe nuk do të ishte më nevoja për fenë e cila do të zhdukej dalë-ngadalë. Por pasojat e këtij sistemi do të bënim që shek. XX për shumë mendimtarë do të shënonte nevojën për kthimin te feja dhe vlerat e saj. Tashmë nga pozitivizmi kanë kaluar dy shekuj dhe parashikimet e Comtes mbi fenë mbeten vetëm një iluzion. Feja e re që ai u përpoq të vendoste në vendin e krishterimit u largua pa e realizuar qëllimin e saj. Kjo eksperiencë njerëzore është në fakt treguesi më i mirë se në cilat caqe përfundon njeriu kur mendja shkëputet nga revelata hyjnore dhe tradita. Edhe pse Comte nuk zuri vendin e pritshëm në histori, pozitivizmi dhe doktrina e tij mbi progresin përbën një realitet të rëndësishëm që do të sundonte Europën dhe të gjithë botën. Si rrjedhojë kjo trashëgimi intelektuale do të prekte dhe transformonte edhe botën islame. Ky fetishizëm mbi përparimin do të sundonte mbi të gjitha shoqëritë dhe jetën njerëzore, por vallë a mund të flitet për të njëjtin zhvillim në lidhje me dimension moral dhe shpirtëror të njeriut? Pikërisht, prej disa shekujsh ndoshta, njeriu modern është kapluar nga një krizë ekzistenciale, e pashembullt ndoshta për qytetërimet e mëhershme. Ky rrugëtim i gjatë

kalon nëpërmjet reflektimit mbi rrënjët etike të këtij vakumi ekzistencial dhe botëkuptimi mbi të cilin ai ka ndërtuar mbi të veten dhe jetën e tij.

Në mediumet tona publike shpeshherë, në emër të progresit dhe Evropës flitet me një fetishizëm të tepruar dhe sakralizues për shkencën si e vërteta e absolute. Ashtu sikurse edhe ndër elitën intelektuale të formuar kryesisht në periudhën e regjimit komunist por jo vetëm, në një gjuhë më shkencore vërtetësia dhe vlera e fesë shpesh shikohet në lupën e përvojës dhe evidencave empirike. Ky fenomen është pikërisht edhe një prej pasojave të shkencizmit dhe absolutizmit të metodave pozitive apo të tjera shkencore e cila si pasojë e suksesit në shkencat natyrore ka ndikuar në themelimin dhe epsitemologjinë e shkencave humane duke krijuar një krizë dhe konfuzion jo të vogël në historinë e zhvillimit të këtyre shkencave. Kjo për vetë faktin se qenia njerëzore është shumë e thellë dhe komplekse dhe nuk mund të kuptohet brenda kufijve të metodave empirike. Atëherë nëse vetë njeriu nuk mund të bëhet objekt i metodave të tilla, si mund perceptohet Zoti apo dimension i hyjnor që është një ekzistencë përtej perceptimit tonë për ekzistencën dhe përtej vëzhgimit dhe arsyes së kufizuar të qenies njerëzore?

Në anën tjetër gjendja duket të jetë krejt e ndryshme botën e zhvilluar. Nëse në njërin anë perëndimi do të ndikohej shume nga parimi i progresit të derivuar nga pozitivizmi, ai do të ndahej shumë me shpejt me perceptimin e pozitivizmit mbi fenë. Siç u përshkrua edhe më lart mendimi pozitivist se feja ishte gabimi më i madh i njerëzimit ka mbetur në të shkuarën. Kështu në dimensionin intelektual dhe katedrat universitare do të zhvilloheshin disiplina shkencore për njohjen e feve të ndryshme dhe u zhvilluan fusha të reja kërkimi mbi dimensionet

filozofike, psikologjike dhe sociologjike të fesë për të kuptuar rëndësinë e saj në shoqëri.

Studimi i fesë është një realitet që ka ndryshuar përgjatë historisë njerëzore sipas botëkuptimit dhe paradigmave të caktuara. Ajo lidhet ngushtë me dialogun midis qytetërimeve dhe atij ndër-fetar. Deri në shekullin e XIV perceptimi dhe studimi mbi fetë, konkretisht midis krishterimit dhe islamit mbizotëronte paragjykimi dhe më pas gjuha polemizuese por pas kësaj kohe do të kishte një qasje më të objektive dhe të shëndetshme në raport me njëra-tjetrën. Me zhvillimin e shkencës moderne, studimi i fesë do të reflektohej në qasjen shkencore ku fetë do të interpretoheshin në perspektivën e shkencave moderne sipas perspektivës dhe qëllimeve praktike për secilën prej tyre. Kjo do të çonte në një polarizim të skajshëm të përkufizimeve mbi fenë dhe zbritjen e realitetit hyjnor të tyre në perspektivën e racionalizmit apo vëzhgimeve empirike.

Në ditët e sotme, një nga qasjet më të njohura dhe objektive kundrejt njohjes dhe studimit të një feje është ajo fenomenologjike. Fenomenologjia e fesë distancohet nga interpretimi partikular i fesë në këndvështrimin historik, antropologjik, sociologjik apo psikologjik duke e trajtuar fenë si fenomen më vete edhe pse ajo lidhet me të gjitha këto dimensione. Me fenomenologjinë konkretisht i referohemi konkretisht me shkollën së Edmund Husserl që do të frymëzonte më pas edhe mendimtarë të tjerë pas tij. Ai do të hidhte poshtë metodën shkencore që mohohej çdo përvojë jetësore në emër të një empirizmi objektiv. Duke e vlerësuar shumë përvojën njerëzore, ai përdori atë si një mjet për të arritur të vërtetën. Kjo qasje që merret me studimin e dukurive dhe ka si objekt të hulumtimeve thelbin e kulluar të gjërave dhe jo sendet në vetvete. Kështu në përshkrimin e një dukurie fetare, studiuesi përpqet të mënjanojë fillimisht

të gjitha besimet, mendimet, paragjykimet apo dijet e tjera mbi atë duke e njohur në mënyrë sa më objektive. Kjo qasje thellohet më tej deri në qasjen simpatike synon të krijojë një qasje ndjesore dhe me afruese me secilën fe dhe qasjen empatike ku studiuesi përpqet të hyjë përkohësisht në horizontin përjetues të tjetrit duke u vendosur në vendin e tjetrit duke njohur dhe përjetuar më në thellësi besimin e tij.

Në përfundim mund të themi se shkëputja e njeriut modern dhe botëkuptimit të tij nga Zoti do ta çonte atë drejt sakralizimit të shkencës dhe mendimit të tij. Shkenca që kërkon çdo gjë të materia do ta çonte atë gjithnjë e më shumë drejt rrënimin moral, trazirave shpirtërore dhe një mendimi sipërfaqësor. Në një botë ku mendja privohet nga mendimi i përjetësisë, shpirti bie në robërinë e teknologjisë dhe jeta shpirtërore braktiset drejt harresës, shkenca dhe çdo formë e diturisë është e padobishme. Shkenca ka nevojë për një botëkuptim të ri që përcakton thelbin, pritshmëritë dhe qëllimet e saj. Ajo duhet të ndërtohet duke përfshirë mendimin e shëndoshë, përvojën dhe ndërgjegjen për ti siguruar njeriut lumturinë materiale dhe shpirtërore duke arritur unitetin mes mendjes dhe shpirtit të tij.

Ashtu sikurse çdo gjë në këtë jetë, çdo kulturë dhe qytetërim ndjek një trajektore të caktuar ku lind, zhvillohet, arrin majat e më pas rrënohet drejt vdekjes. Ashtu sikurse errësira plotë e natës lajmëron lindjen e agimit dhe dimri i ftohtë është lajmëtar i pranverës. Edhe njerëzimi, pas një aventure të tillë prej disa shekujsh në përpëllitjen për të gjetur burimin e vërtetë të dritës, jemi shpresëplotë se ai e ka kuptuar gabimin e tij dhe nevojën për t'iu kthyer edhe njëherë vetes dhe natyrës së tij të pastër. Për tu kthyer drejt origjinës së tij, drejt parajsës së humbur.



AGJËRIMI

Një nga shtyllat e adhurimit në Islam



Prej tefsirit të Muhammed Hamdi Yazır, Hak dini Kur'an dili (Feja e drejtë, fjala e Kur'anit):

“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat.” (Bekare 2: 183)

Agjërimi është një nga shtyllat më të mëdha të fesë tonë dhe një nga ligjet më të fuqishme të Legjislacionit Islam. Nefsi (e kundërta e ndërgjegjes) që urdhëron vazhdimisht të keqen (en-nefs el-emmare bi es-su') mund të edukohet me këtë xhihad¹ dhe dëshira e shfrenuar ndaj të keqes mund të qetësohet në këtë formë. Agjërimi, kjo vepër e zemrës, është një xhihad i shenjtë, i cili formohet nga mbajtja e neftsit larg dëshirave trupore si ngrënia, pirja dhe marrëdhëniet intime përgjatë një orari të caktuar ditës.

1. Përpjekja e njeriut për të dalë i fituar ndaj anës së tij të brendshme negative.

Është një nga adhurimet më të bukur, me anë të të cilit merr shijen e jetës dhe kupton vlerën e vullnetit. Por neftsit të njeriut, i duket si vepra më e vështirë ndër urdhëresave hyjnore. Për këtë arsye, urtësia hyjnore ka dashur që urdhëresat adhurimore t'i nisë nga më i lehti, që është namazi, pastaj ai i mesmi, që është zekati dhe në radhë të tretë ka urdhëruar agjërimin, që është më i vështiri mes të treve. Në këtë formë, personat përgjegjës fetarisht i ka njohur dalëngadalë me adhurimet e detyrueshme.

Për këtë arsye, edhe në ajetin “...të përlurit dhe të përlurur, mirëbërësit dhe mirëbërëset (lëmoshëdhënësit dhe lëmoshëdhënëset), agjëruarit dhe agjëruarit...” (Ahzab 33: 35) gjatë lëvdatave është ruajtur e njëjta radhitje. Gjithashtu në hadithin ku përmenden shtyllat e Islamit, është ruajtur e njëjta radhitje duke thënë:

“Dëshmia, namazi, zekati, agjërimi i ramazanit dhe haxhi”².

Në periudhën e parë pas hixhretit të Profetit a.s. në Medinë, i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të, kishte urdhëruar si nafile agjërimin e tre ditëve në muaj dhe të ditës së ashures. Ky quhet agjërimi i parë. Agjërimi i muajit ramazan është bërë farz një vit e gjysëm pas hixhretit, pas ndryshimit të kibles, në 10 shaban.

Megjithatë disa dijetarë janë të mendimit që ajeti i mësipërm ka ardhur në lidhje me agjërimin e parë dhe që është shfuqizuar me zbritjen e ajetit të agjërimit të ramazanit, mendimi më i drejtë është që ajetet ku përmendet agjërimi, kanë qenë gjithmonë në lidhje me muajin ramazan. Pra, “O ju që keni qenë përgjegjës për besim dhe që keni besuar! O besimtarë me zhvillim mendor normal dhe që keni arritur në moshën e pjekurisë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar profetëve para jush dhe umeteve të tyre”. Prandaj, mos u mërzisni duke menduar se barra e agjërimit ju është ngarkuar vetëm juve. Agjërimi është një urdhër hyjnor që ka qenë praktikuar që prej kohëve të hershme. Njerëzimi ka shumë nevojë për të në aspektin e edukimit dhe rregullsisë, dhe prej tij përfiton dobi të panumërta.

Fjalët “sijam” dhe “saum” kanë kuptimin e agjërimit. Në leksik “sijam” do të thotë të privosh veten nga diçka, qoftë edhe një fjalë. Në ajetin “Unë jam betuar në të Gjithëmëshirshmin se do të agjëroj, prandaj sot nuk do të flas me askënd.” (Merjem 29: 26) është përdorur në kuptimin e privimit prej fjalës.

Sipas ajeteve dhe traditës profetike, kuptimi i agjërimit në jurisprudencën islame është kështu: “Të ndalosh veten nga dëshirat më të mëdha të nefsit, që janë gjithashtu edhe disa prej nevojave me të domosdoshme trupore, si ngrënia, pirja dhe marrëdhëniet intime”. Nëse do ta përkufizonim teknikisht mund të themi kështu: “Privimi prej ngrënies, pirjes dhe marrëdhënieve intime, që një person përgjegjës i bën vetes, duke nisur nga agimi deri në perëndim të diellit me qëllim adhurimi”. Në këtë aspekt, nëse diçka hyn në trupin e njeriut edhe me ndonjë rrugë tjetër përveç gojës ose hundës, p.sh., me shiringë, agjërimi prishet.

“E pra o besimtarë! Juve ju është bërë farz agjërimi” në mënyrë që të mbron veten tuaj. Me anë të agjërimit do të mësoni që t’i bëni ballë nefsit dhe kërkesave të tij. Kështu do të ruheni prej mëkateve dhe do të keni mundësinë të arrini gradat e devotshmërisë.

Sepse agjërimi thyen epshin dhe mund dëshirat e nefsit. Ndalon nga tepricat dhe veprat negative. Shijet e ulëta të dynjasë, dëshirat për post e për të qenë sa më lart, i tregojnë të vogla, të jep shijen e vërtetë të jetës, shton lidhjen e zemrës me Allahun dhe agjëruesis i dhuron një kënaqësi e pastërti engjëjlore. Sepse, duke u bazuar edhe në një fjalë të moçme ku thuhet “Njeriu vrapon për

dy zbrazëtitë, stomakun dhe organin gjenital”³, ato që i hapin më tepër probleme njerëzve janë epshi i stomakut dhe i organit gjenital. Të jesh njeri do të thotë t’i dalësh për zot këtyre dy epsheve.

Agjërimi në krye thyen këto dy elemente dhe u jep atyre njëfarë rregullsie. Veprat që ato ia imponojnë njeriut sikur të ishin nevoja esenciale, agjërimi i kthen në të varura nga dëshira e vullneti i tij. Personat që nuk agjërojnë, duke mos i dalë për zot arsyes dhe vullnetit të tyre, kthehen në kuklla të këtyre dëshirave trupore, dominohen prej tyre dhe jeta u kalon në detin e mëkateve. Kurse personat që agjërojnë, janë dominues mbi elementët e lartpërmendur. Ata dinë ta përmbajë veten dhe t’i përdorin dëshirat e nefsit sipas nevojës. Për këtë arsye, Profeti, paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të, personave që nuk e kontrollojnë dot nefsën e tyre i këshillon agjërimin⁴.

Kush nuk agjëron, nuk di të durojë. Ai nuk di as ta përdorë nefsën aty ku duhet. Sidomos personat që jetojnë në bollëk dhe mirëqenie, nëse nuk agjërojnë, të gjithë lirinë ia ozurpojnë dëshirat trupore. Nuk e ndalojnë dot veten nga dhunimi i dëlirësisë apo pasurisë së të tjerëve. Nuk e dallojnë dot hallallin nga harami. Madje hidhen në këto poshtërsira pa dëshirën e ndërgjegjes. Si rezultat, shkelin edhe të drejtat e nefsit, dhe e konsumojnë veten në të kundërt të asaj që kërkon arsyeja dhe ndërgjegjja, feja dhe besimi.

Personave që e kanë shfrenuar veten, patjetër që agjërimi do t’i duket si tepër i vështirë dhe i parealizueshëm. Në fakt ai është një edukim moral, ashtu siç është edhe një edukim fizik si një pushim i domosdoshëm për stomakun tonë nga aspekti mjekësor.

Por, përveç gjithë këtyre dobive, që janë si individuale, ashtu dhe shoqërore, nuk duhet të harrojmë që urtësia kryesore e përcaktimit si detyrim të agjërimit, është të bësh xhihad me nefsën për të arritur në shijimin robërisë ndaj Krijuesit duke iu bindur urdhërave të Tij, për të fuqizuar sinqeritetin duke u pastruar nga çdo shenjë e hipokrizisë dhe për t’ia dorëzuar veten mbrojtjes hyjnore.

Pikërisht në lidhje me këtë, në një hadith kudsithuhet: “Agjërimi është për Mua. Shpërblimin e tij vetëm Unë mund ta jap”⁵. Kështu, fjalia “që të mund të ruheni nga të këqijat”, është shprehje hyjnore, e cila cilëson me të gjithë gjerësinë e mundshme urtësitë dhe dobiet, shkaqet dhe qëllimet e agjërimit. Të gjitha këto qëllime shpirtërore e materiale, fetare e tokësore, janë të grumbulluara në shprehjen “që të mund të ruheni”.

Ja pra, agjërimi, që duket si një adhurim tepër i vështirë, është një adhurim kaq i bukur e i dobishëm.

3. Ez-Zemahsheri, Esâsu el-Belaga, 458; ez-Zebidi, Tuxh el-Arus, III. 458.

4. Buhari, Saum, 10; Nikah, 2,3; Muslim, Nikah, 1; Nesai, Sijam, 43; Ibn Maxhe, Nikah, I; Darimî, Nikah, 2.

5. Buhari, Saum, 9; Muslim Sijam, 160,162,164; Tirmidhi, Sijam. 54; Nesai,Sijam, 41, Ibn Maxhe, Edeb, 58,Sijam, 1; Muvatta, Sijam, 58; Ahmed b. Hanbel, I, 446, II, 232,234.

2. Buhari, Iman, 1,3; Muslim, 19-22; Tirmidhi, Iman, 3; Nesai, Iman, 13.

Koha kalon, fëmijët rriten



Nuk më besohej kur dëgjoja se 'koha kalon shpejt, fluturon'...

Foshnja e vockël që deri dje mbaja në duar tani ka mbushur 3 vjeç. Megjithatë netët e kaluara pa gjumë, dhimbjet e gjoksit nuk më duken aq të largëta. T'ia nxjerr gazrat, ta pastroj, ta ushqej, ta vë në gjumë dhe ja tani ecën këmba dorazi. Tani shëtit në majë të kolltukëve. Koha kalon aq shpejt sa që njeriu harron atë që ka përjetuar. Tani, teksa dëgjoj shoqet e mia me fëmijë më të vegjël se unë, përpiqem të kujtoj dhe mendoj të shkuarën.

Njëra nga shoqet ankohet se fëmija nuk ia merr biberonin, tjetra është shumë e lodhur, e sflitur, sepse qëndron zgjuar gjithë natën për shkak të gazrave. Kur rritet pak, fillojmë të ankohemi se na rri gjithë ditën ngjeshur duke menduar se vetëm fëmija ynë e bën diçka të tillë. Nuk është ashtu, çdo gjë që përjetojmë është pjesë e një procesi natyral. Në fillim duhet të ndihemi mirë dhe të falënderojmë Zotin që kemi një fëmijë të shëndetshëm dhe më pas, të mos i hiperbolizojmë gjërat, por të pranojmë gjendjen ashtu siç është.

Ç'është e vërteta, kur filloni të pranoni problemet, ato nuk ju shqetësojnë më si më parë. Dhe e gjithë kjo është krejt normale. Tre muajt e parë fëmija sigurisht që do të ketë gazra, por do t'i kalojnë sapo të fillojë të sillet, të lëvizë vetë. Nuk ushqehet me shishe apo nuk merr biberonin? Le të mos e marrë, pa mendohu pak, nuk do të shqetësohesh për ta mësuar të heqë dorë nga biberoni. E vetmja gjë që do të bësh është t'ia heqësh gjirin kur të duket e përshtatshme. Dhe tashmë është 18 muajsh, vogëlushi nuk rri në një vend, është shumë

i lëvizshëm? Pritej diçka e tillë. Kjo periudhë kalon duke iu ngjitur këmbëve të nënës. Dhe e di mirë që do të turfullosh duke thënë: 'mjaft më, rri një minutë rehat'. Unë nuk mund të shkoja as në banjë kur ai ishte zgjuar. Shumë e mërzitshme, e sikletshme, po ja që kështu është kjo punë. Ne jemi nëna dhe fëmija ndihet i sigurt dhe i qetë vetëm pranë nesh. Ai e di mirë që nëna e tij e kupton, e mbron, e ushqen. Nëse mendoni kështu, më besoni se do t'ju kalojë dhe ajo ndjenja e mërzisë së mëparshme.

Mos u merakosni shumë dhe mos u frikësoni nga sindroma e moshës 2 vjeç. Edhe ajo është një shkallë që do të kalohet. Në vend të fjalëve 'pse është kështu fëmija im?', ka ardhur koha të thonit: 'vogëlushi im po rritet'. Respektojeni atë. Ai e ka më të vështirë se ju. Përpiqet ta tregojë hallin e tij me gjuhën që sapo ka filluar t'i zgjidhet, nuk e keni kuptuar akoma? Mund të zemërohet menjëherë. Përqafojeni fort dhe mos i bërtisni apo zemëroheni me të.

Dhe pa kaluar shumë kohë të gjitha harrohen. Vogëlushi juaj do të fillojë të luajë. Madje do të thotë 'ik mami ti, hajde më vonë'. Kur e kuptoni se nuk jeni e dëshiruar, ndiheni aq keq sa që as ju vetë nuk e imagjinoni. A nuk ishin këto momentet që kishit ëndërruar, imagjinuar muaj të tërë? Jemi shumë të çuditshëm. Duam edhe të marrim frymë lirisht edhe të ndjejmë frymën e fëmijës sonë në faqe.

Tani buzëqesh kur i hedh një sy të shkuarës. Përpiqem të kujtoj mërzitë, lodhjet, krizat e gjumit, por nuk mundem. I paskam harruar të gjitha sepse koha kalon. Mbrapa mbesin vetëm kujtimet e bukura dhe aroma e këndshme e fëmijës.

Le ta presim Ramazanin **si të ishte i fundit**



Allahu i madhërishëm në Kuranin fisnik urdhëron e thotë:

"O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.

(Jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmure prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri, ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për te. Mirëpo, po qe se e dini, agjërimi është më i mirë për ju.

(Ato ditë të numëruara janë) Muaji i Ramadanit që në te (filloi të) shpallet Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria). E kush e përjeton prej jush këtë muaj le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmure ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju. (Të agjëroni ditët e lëshuara më vonë) Që të plotësoni numrin, ta madhëroni All-llahun për atë se u udhëzoi dhe që të falënderoni."

(El - Bekare, 183 - 185)

Kur njeriu kryen një punë, ose viziton një vend të caktuar, apo takohet me një person të dashur dhe me këtë rast mendon që nuk do të ketë rastin tjetër, kjo i fuqizon ndjenjat që këtë rast duhet shfrytëzuar sa më mirë ngase nuk përsëritet më. Kur sahabët dëgjonin këshillat e Pejgamberit, s.a.v.s., sytë u lotonin, zemrat u dridheshin, thonin: "Sikur kjo është këshilla e fundit, lamtumirëse e cila nuk kthehet më!?" (Tirmidhiu)

Në haxhin e lamtumirës, Pejgamberi, s.a.v.s., para turmës së mbledhur u drejtoi fjalët e udhëzimit dhe këshillat që ishin përmbledhje e pejgamberisë shumëvjeçare. Një fshehtësi e këshillës së tij drejtuar një sahabiu ishte: "Kur ngritesh për të falë namazin, fale sikur me qenë i fundit në jetë!" (Ibn Maxheh)

Paramendoni njeriun i cili falet me singëritet duke ditur se është namazi i fundit i tij... sa do të mundohet ta kryejë me përkushtim... me përlësi... i singërtë në lutjet e tij! Pejgamberi, s.a.v.s., na udhëzon dhe këshillon si të lirohemi nga kurtha e transformimit të ibadetit në adet - imitim.

Përse edhe ne nuk përpiqemi që ibadetet tona t'i bëjmë

me përkushtim, sikur me qenë të fundit?! Gjithsesi jemi në udhëtim pa fund. Namazet tona nuk janë të vetmit që janë të ekspozuar rrezikut që të transformohen nga ibadeti në adet.

Ramazani është mysafiri ynë më i dashur. Ai do të na fisnikërojë nëse ndaj tij jemi fisnik. Me ardhjen e tij, përjetojmë ardhjen e bereqetit dhe mirësive të panumërta. Ai është mysafir që duhet pritur bukur. Ndoshta dikush prej nesh do ta pret për herë të fundit. Andaj, ta gostitim bukur mysafirin e dashur! T'i shfrytëzojmë momentet që t'i kalojmë me të!

Besimtarë të nderuar, ejani që bashkarisht të arrijmë ndjenjat të cilat i ka dikush kur me një të dashur ndahet përgjithmonë, ta forcojmë besimin tonë duke kaluar këtë muaj të bekuar në shkallën më të lartë të vëmendjes dhe brengës sikurse me qenë i fundit në jetë duke shpresuar fuqishëm në shpërblimin dhe faljen e Allahut ndaj mëkateve tona të cilat janë të shumta.

Le të përpiqemi që këtë Ramazan ta studiojmë Kuranin fisnik duke medituar thellë për versetet e tij.

Përveç ushqimit trupor le të pasurohemi me ushqim shpirtëror, të mundohemi t'i gëzojmë familjet tona, farefisnin tonë dhe besimtarët e tjerë.

Le të përpiqemi të bëjmë sa më shumë vepra të mira.

Këtë vit le të përpiqemi që në vetmi të bëjmë llogari me vetveten.

Afrohu në safë me ata që nuk i njeh! Renditi rreshtat pas imami me qëllim të bashkimit të zemrave në rrugën e vërtetë.

Edhe unë edhe ti kemi armi. Të mbrohemi nga ata me lutje.

Për çdo vit dëgjojmë për vlerat e mëdha të këtij muaji të bekuar. Mundohu këtë vit që brenga yte kryesore të jetë shfrytëzimi i të gjitha begative të këtij muaji.

Vlera kulmore e Ramazanit arrin në natën e Kadrit. A ke menduar ndoshta viteve të kaluara e ke lëshuar rastin e këtyre vlerave? Shfrytëzoje këtë vit që sa më shumë të kalosh në ibadet, dhikër, mirësi, sepse ndoshta nuk do ta përjetosh më këtë!

Sill vendim të fuqishëm për fillim të ri me pendim të singërtë dhe kthim kah Allahu i madhërishëm.

Zot i dashur, na beko në këtë muaj. Na ndihmo të agjërojmë në mënyrë të drejtë dhe na bëj prej atyre që u ke pranuar agjërimin dhe na bëj prej të devotshmëve.

Suneti i pastër i Muhamedit ﷺ, burim i pastër për arsimin, kulturën dhe civilizimin islam



Suneti i pastër i Muhamedit a.s., burim i pastër për arsimin, kulturën dhe civilizimin islam

Në historinë e kulturës dhe shkencës islame në Shqipëri, dallohet studiuesi dhe mësuesi H. Ibrahim Dalliu, i cili me botimet origjinale teologjike e publicistike si dhe në fushën e përkthimeve, ka dhënë një kontribut të rëndësishëm me vlera shpirtërore për myslimanët shqiptarë. Një nga përkthimet më të rëndësishme të botuar në vitin 1936 titullohet "Udha Muhamedane". Ky libër me autor Imam Bergeriun (1522-1599), ka vlera të mëdha sepse është një nga veprat bazë ku merren shpjegime për çështje të moralit, kulturës dhe jurisprudencës islame. H. Dalliu në parathënien e librit shprehet: "E përktheva këtë libër, që të përfitojnë shqiptarët musliman nga ai ose më mirë të themi: të mësojnë se çfarë sendesh janë të ndaluara nga ana e Zotit dhe e profetit të tij, dhe me çfarë detyrash janë të urdhëruar fetarisht ata." Më poshtë shprehet: "Edhe me qenë se ka krizë financiare do t'i japim pa para". Ishte pikërisht Hafiz Dalliu i cili kontribuoi e sakrifikoi për myslimanët shqiptarë dhe njëkohësisht si patriot atdhetar që ishte, u persekutua e u burgos disa herë. Myslimanët shqiptarë duhet ta studiojnë këtë libër sepse bën fjalë për rrugën që duhet të ndjekin në të kuptuarit e Sunetit të Muhamedit (a.s.), në rregullat e saktësimit të teksteve të hadithit dhe çështje të tjera, që ndihmojnë për arsimin, për të fituar kulturë të gjerë shkencore, që të çon drejt civilizimit islam.

Në këtë mënyrë do të vihet feja Islame në vendin që meriton, si paraprijëse e të gjithë niveleve kulturore e civilizuese, e jo të reduktohet vetëm në sjellje personale të çdo besimtari, ose në disa aspekte formale të jashtme, që nuk bëhen pjesë e shoqërisë dhe që nuk krijojnë unitet për të ndihmuar në civilizimin e saj. Islami është themeli i jetës dhe e obligon çdo besimtar t'i përmbahet Librit të Allahut dhe Sunetit të Dërguarit, Muhamedit (a.s.). Prandaj dhe H. Dalliu e vë theksin në këtë libër që t'i kthehemi Islamit të plotë, besimit të tij, ligjit, adhurimit, moralit, marrëdhënieve ndërnjerëzore sipas parimeve të tij. Në kapitujt që përmban libri kuptojmë që Islami për besimtarët e tij është program jete dhe e rregullon atë në të gjitha fushat e saj. Por që të realizohet kjo, kërkon si domosdoshmëri që t'i paraprijë besimi i singertë në Zotin e Amshuar. Ky

besim bën baraspeshën midis mendjes dhe zemrës, bashkon shpirtin me trupin, idealen me realen, individin me shoqërinë mes të drejtës personale dhe interesit shoqëror. Atëherë do të kemi një njeri të mirë, familje të shëndoshë e për rrjedhojë një shoqëri pa fenomene negative. Zoti në Kur'an na porosit: "Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli përderisa ata të ndryshojnë veten e tyre" (Rad, 11). Prandaj, në qoftë se dëshirojmë një shoqëri të shëndoshë me virtyte e morale të ndershme t'i mbështetemi besimit, sepse ai i jep energji personalitetit, krijon një ndërgjegje të pastër, formon qytetarin e denjë për një shoqëri që sheh përpara drejt civilizimit të saj.

Mirëpo myslimanët sot ushqehen me mësim të historisë islame të trashëguara me karakteristikat e saj sipas etapave të ndryshme si dhe me kulturën fetare të importuar, të përkthyer ose jo. Përballë këtyre dy kulturave të pakontrolluara, pa u bazuar në traditën dhe historinë dhe kulturën e popullit shqiptar e teologëve të tij, besimtari i paarsimuar mbetet i çoroditur, ndërsa intelektual i mysliman bashkëkohor si konsumues i kësaj kulture, është i paaftë për të vepruar, për të prodhuar kulturë e për të orientuar në vlerat e qytetërimit islam. Intelektuali islam dhe teologët e mirëfilltë duhet të japin një vizion më të qartë gjithë kërkesave të kësaj periudhe dhe të bëhen të vëmendshëm në interpretimin e burimeve të sakta të Islamit, Kur'anit dhe Hadithit, ashtu siç shprehet Hafiz Dalliu: "Thoni se arsyet mendore dhe argumentet tradicionale fetare janë të bashkuara në Librin e shenjtë, Kuranin dhe fjalët e madhërueshme të Pejgamberit a.s."

Prandaj këto burime duhet të studiohen e të kuptohen drejt nga një këndvështrim bashkëkohor, për të sqaruar rregullat e përgjithshme të Islamit dhe për të vendosur programin e domosdoshëm, me qëllim që Islami t'i përgjigjet sfidave të kohës. Intelektualët teologë bashkëkohës të H. Ibrahim Dalliu u mbështetën në Kur'anin e Madhëruar dhe Sunetin e Profetit (a.s.), në studimin e tyre me metoda origjinale. Kjo u dha mundësi t'i kuptojnë e transmetojnë drejtë te besimtarët myslimanë, të bëjnë analiza me realitetin dhe ligjet dhe t'i integrojnë ato në shoqëri, për të mbrojtur gjuhën, traditën, fenë dhe atdheun. H. Ibrahim Dalliu që përktheu nga origjinali veprën "Udha Muhamedane", flet në praktikë për ndjekjen e rrugës së

Muhamedit, për biografinë dhe mënyrën e jetesës së tij dhe të jetesës si pejgamber. Ky studim pasqyron mishërimin shkencor dhe aktual të metodës që duhet ndjekur. Prandaj dhe Dalliu në këtë vepër shprehet: "Nuk bëhet ndryshe veçse me ndjekjen e vulës së profetëve, profetit të fundit, Muhamedit, që është i madhi ynë dhe i madhi i të parëve e të mbrapmëve në besim, në fjalë, në moral dhe në vepra". Në këtë mënyrë vjen të kuptuarit e qartë të Sunetit, njohja e qëllimeve dhe e synimeve praktike të tij, duke bërë të mundur që të zhduket injoranca, të mënjanoen konfliktet dhe të bëhet faktor i dobishëm në shoqëri. Kjo tregon se nuk mjafton vetëm kuptimi i jashtëm formal i udhës së Profetit (a.s.), por më shumë ka rëndësi të kapurit pas brendësisë, shpirtit të tij, duke shmangur deformimet e atyre që hiqen si të ditur. Për këtë dijetari bashkëkohor, doktor Jusuf Kardavi në veprën e tij "Si të bashkëveprojmë me Sunetin", shprehet: "Ka disa neglizhues, të cilët duan të hyjnë dhe flasin për Allahun e Pejgamberin e Tij atë që nuk e dinë..." Nga kjo thënie kuptohet se duhet ta ruajmë të pastër hadithin e Profetit (a.s.), të mos i zmadhojmë gjërat e as të mos i deformatojmë ato gjoja në emër të ndjekjes së rrugës së tij.

Dihet që Suneti i Muhamedit (a.s.) është interpretimi praktik i Kur'anit dhe zbatimi real i Islamit. Zoti në Kur'an thotë: "Me të vërtetë juve ju erdhi prej Allahut dritë (i Dërguari) dhe një libër i qartë (Kur'ani), me të cilin Allahu i drejton ata që ndjekin pëlqimin e Tij në udhën e shpëtimit, i nxjerr ata prej errësirës në dritë, me lejen dhe vullnetin e Vet dhe i shpie në udhën e drejtë..." (Maide, 15-16). Këtë udhë të drejtë e praktikoi dhe e ndoqi me saktësi Muhamedi (a.s.) dhe prandaj vepra titullohet "Udha Muhamedane". Kjo udhë përbën Sunetin e tij, që përmbledh tërë jetën e njeriut, që nga lindja e deri në vdekje dhe më tej, që nga krijimi i embrionit deri pas vdekjes. Me një fjalë përfshin të gjitha fushat e jetës individuale, familjare e shoqërore si dhe lidhjen e ngushtë me Zotin e tij jo vetëm në këtë botë, por edhe në botën tjetër. Pra, për të njohur Islamit praktik me bazat e tij, duhet mësuar e ndjekur Suneti i

Pejgamberit (a.s.), për të cilin Zoti në Kur'an urdhëron e thotë: "Ai që i bindet të dërguarit të Allahut, i është bindur edhe Allahut" (Nisa, 80). Prandaj dhe autori për të ndihmuar besimtarët që të përsosin moralin e tyre duke ndjekur si shembull H. Muhamedin, botoi këtë libër me rëndësi moralo-shpirtërore e jetike. Bashkëshortja e Pejgamberit (a.s.), Aishja r.a. thotë: "Moral i tij ishte Kur'ani." Kjo do të thotë se Suneti i Pejgamberit (a.s.) është rruga apo udha që duhet të ndjekë çdo mysliman sepse përfaqëson Kur'anin e interpretuar dhe Islamit e vërtetë në praktikë, në punë, në fjalë dhe gjithë jetën e çdo besimtari, në atë individuale e shoqërore, me farefisnin e më gjerë, në çdo rrethanë e moment të jetës, pa u shkëputur nga lidhja me Zotin e madhëruar. Kjo e detyron besimtarin që të kuptojë mirë udhën jetësore që përshkoi Muhamedi (a.s.) për të qenë korrekt me ligjet juridike, morale, edukative, si individ, në familje dhe shoqëri.

Gjatë komentit të veprës "Udha Muhamedane", nuk kemi për qëllim të ndalemi thjesht në ajete dhe hadithe që sillen në kapituj të veçantë. Qëllimi është të kuptojmë të vërtetën, Islamit në tërësi të mishëruar në jetën e Muhamedit (a.s.); të njohim personalitetin e tij përmes jetës dhe veprës; të krijojmë bindjen se nuk ka qenë vetëm gjeni, që shquhesh në mesin e popullit, por, para së gjithash, ai ka qenë i dërguari i Zotit me shpallje, që nëpërmjet saj krijoi kushtetutën, bëri shtet e perandori dhe të gjithë iu përmbajtën rrugës së tij.

Autori përmes kësaj vepre na lejon të kuptojmë se me studimin e saj pasurohem më shumë me kulturë islame si në fushën e besimit, ligjit apo moralit, sepse jeta e Pejgamberit (a.s.) është objekti i ndriçuar në të cilin janë skalitur ligjet e besimit islam. Hadithet që sillen në këtë libër na ndihmojnë për zgjidhjen e shumë problemeve dhe gjetjen e rrugëve më të drejta, për çdo gjë që ka të bëjë me jetën, me punën, familjen, ushqimin, veshjen, marrëdhëniet me njerëzit e deri me kafshët.

Të ndjekim udhën e H. Muhamedit (a.s.) sepse natyra dhe karakteri i tij janë aq të pastra, saqë ai në çdo çështje është i vërtetë,

i drejtpërdrejtë dhe fisnik. Ai gjithmonë ka frymëzuar virtyte të larta e drejtësi, dhe i zbatonte vetë e pastaj i predikonte te të tjerët. Gjithë jeta e tij është në harmoni me Islamin. As fjala, as vepra nuk janë nxitur nga interesi personal. Ai ka vuajtur për të mirën e të tjerëve, por asnjëherë nuk i ka bërë të tjerë të vuajnë për të. Jeta e tij është shembull i fisnikërisë së vërtetë, pastërtisë së mendjes së ndritur e të lartë. Muhamedi (a.s.) është forma më e lartësuar e qenie njerëzore, karakteri i tij është pa të meta. Si i dërguar i Allahut duhet ndjekur udha e tij, fjalët e tij duhen pranuar, udhëzimeve dhe urdhrave të tij duhet t'i bindemi. Mosbindja ndaj tij është mosbindje ndaj Allahut, dhe kjo patjetër të çon në degjenerim e shkatërrim. Është për t'u çuditur se shumë njerëz me emrin besimtar pranojnë vërtetësinë e Profetit, por nga ana tjetër nuk ndjekin rrugën e tij në problemet e jetës. Shpesh mohimi i së vërtetës nga secili është si rezultat i injorancës apo arrogancës së tij si dhe të paragjyqimeve që ai lëshon.

Në këtë libër autori vë theksin se profeti Muhamed është i dërguari i Zotit, për të përçar te njerëzit mesazhin e tij. Është urdhri i Allahut që njerëzit të besojnë dhe të ndjekin të dërguarin e Tij. Ashtu siç thuhet në Kur'an: "Ne i dërguam të dërguarit tanë me dëshmi të qarta dhe Ne zbritëm me ata, librin dhe drejtësinë, që njerëzit t'i përmbahen të drejtës." (Hadid, 25). Nga ajeti kuptohet se detyra e njeriut është të pranojë Profetin dhe të ndjekë gjurmët e tij. Kjo është rruga drejt shpëtimit sepse jeta e tij paraqet veprën praktike, e cila trupëzoi realitetin e plotë islam, personalitetin e tij më të lartë në çdo sferë të jetës, në mënyrë më të plotë dhe më të qartë. Prandaj dhe Zoti u drejtohet njerëzve me këto fjalë në Kur'an: "Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut" (Ahzab, 20).

Suneti i Pejgamberit (a.s.) jo vetëm shpjegon Kur'anin, por nuk ndahet prej tij, e prandaj ai është burimi i ligjeve islame si adhurimi, marrëdhëniet mes njëri-tjetrit, me familjen, shoqërinë e shtetin. Ai sjell argumente të qarta me fjali kuptimplote për urtësi në sjellje, jep këshilla prekëse, tregime edukative, reflektim të urdhrave e ndalesave, nxitjes

dhe frikësimit, gjëra të cilat zbusin zemrat e ngurta, lëvizin synimet e heshtura etj. Autori në "Udha Muhamedane" sjell argumente që H. Muhamedi ndjek të njëjtën rrugë në të komunikuar në secilin si një tërësi, bashkon mendjen dhe zemrën, duke punuar për të formuar personalitetin e plotë të besimtarit, me mendje të lartë, zemër të pastër e trup të shëndetshëm. Në këtë libër që përfshin Sunetin e Profetit (a.s.), për secilin ka një kapital të pashtershëm për ta udhëhequr atë në punë të mbara dhe të mira të dobishme për jetën e tij.

Që ta kuptojmë drejt Sunetin, autori gjithnjë ka sjellë argumente e përshtatje me Kur'anin, ashtu siç sjell ajetin 115 të sures "En'am" ku Allahu thotë: "Fjalët e Zotit tënd janë të vërteta dhe plot të drejta, nuk ka kush të drejtë të ndryshojë fjalët e Tij. Ai është që dëgjon e di." Me këtë ajet vërtetohet se Kur'ani është shpirti i ekzistencës së Islamit dhe themeli bazë i tij, është në rolin e kushtetues origjinale, ku të gjitha ligjet kanë origjinën e tyre. Profeti Muhamed është shpjegues i kësaj kushtetute, sqarues i saj dhe në të njëjtën kohë ai e praktikoi për njerëzit që të ndjekin rrugën e tij. Interpretimi i Kur'anit, çiltërsia në të cilin e paraqiti Pejgamberi (a.s.) dhe pas tij saktësia e Sunetit apo udha e tij përbëjnë ligjet e Islamit, për një kulturë të gjerë e civilizim bashkëkohor, të cilët ia rrisin besimin në vetvete secilit besimtar.

Nëpërmjet librit "Udha Muhamedane" ne arrijmë të njihemi me poseduesin e moralit më të lartë, thirrësin e mëshirshëm, bashkëshortin ideal, edukatorin e njerëzve me anë të konsultimeve, mëshiruesin për besimtarët, të kujdesshmin ndaj të gjithëve dhe bartësin e flamurit islam. Ai ishte politikan me vizion të qartë, udhëheqës ushtarak i zoti, por ishte dhe prind i dashur e i butë, i afërt me familjen e tij dhe shok besnik; ndihmonte dhe jepte nga dashuria dhe butësia e tij, nxitës për arsimin dhe kulturën. Ky është morali shembullor, që duhet të përfitojë çdo besimtar e të ndjekë udhën e tij dhe mbi bazën e këtyre vlerave të ndërtojë jetën individuale e familjare në shoqërinë e tij.

Reflektime udhëtarësh nga viti në vit



Nëse ka një gjë të sigurt në jetën e kësaj bote, ajo është koha, e cila ecën pa ndalur. Askush nuk mund ta ndalë kohën. Vetë qenia jonë njerëzore dëshmon për këtë fakt. Ne kemi ardhur në këtë botë jo për të qëndruar përgjithmonë. Të gjithë e dinë këtë të vërtetë, duan apo nuk duan ta pranojnë.

Njeriu në këtë jetë i ngjan një udhëtar që ndalon për pak çaste nën hijen e një peme, pastaj vazhdon rrugëtimin e tij, siç e përshkruan Profeti Muhamed (a.s). (Tirmidhiu).

Duke qenë kështu, ajo që na takon neve si njerëz është të dimë ta shfrytëzojmë kohën. Shfrytëzimi i kohës do të thotë shfrytëzim i jetës sonë, ta jetojmë atë në mënyrën më të mirë të mundshme. Pikërisht këtu qëndron dallimi thelbësor ndërmjet njerëzve dhe ideologjive të ndryshme që mundohen të japin sygjërime për mënyrë se si duhet jetuar jeta.

Dikush që nuk beson në Zot mund të thotë: "Kam vetëm një jetë, prandaj duhet ta jetoj duke shfrytëzuar të gjitha kënaqësitë e kësaj bote." Ndërsa dikush që beson në Zot pranon se kjo jetë është një sprovë dhe përpiket ta jetojë atë sipas asaj që e kënaq Allahun (xh.sh).

Prandaj, fitimtari i vërtetë është ai që jeton këtë jetë duke kënaqur Krijuesin e tij dhe duke qenë i bindur në takimin me Të. Me të drejtë lind pyetja: a po jetojmë një jetë që e kënaq Zotin tonë, apo një jetë që e hidhëron Atë?

Përgjigjen e kësaj pyetjeje e gjejmë në Kuranin Fisnik. Allahu (xh.sh.) në Suren El-Asr betohet në kohë:

"Betohem në kohën!

Nuk ka dyshim se njeriu është në humbje, përveç atyre që besuan, bënë vepra të mira, e këshilluan njëri-tjetrin për të vërtetën dhe për durimin."

(El-Asr, 1-3)

Në këto ajete shihet qartë se njeriu fitimtar është ai që e kalon jetën në besim dhe vepra të mira, në dobi të vetes dhe të të tjerëve. Imam Fahreddin er-Razi tregon se kuptimin e vërtetë të sures El-Asr e kuptoi kur dëgjoi një tregtar në treg që shiste akull dhe thërriste:

"Ejani, blini nga unë! Kini mëshirë për këtë njeri, malli i të cilit po shkrihet!"

Kështu është edhe jeta e njeriut, si akulli: nëse çdo moment i saj nuk shfrytëzohet siç duhet, ajo shkon kot, pa dobi, ashtu siç shkrihet akulli nën rrezet e diellit.

(Tefsirul-Kebir, Imam Razi – Mefatih el-Gajb)

Prandaj vitet ekin, por njeriu duhet të bëjë llogari se si e ka jetuar vitin që ia pas. Kjo vetëllogaritje është shumë e vlerësuar në traditën islame. Në këshillat e Profetit Muhamed (a.s) gjejmë udhëzime të qarta për reflektim dhe përmirësim të vazhdueshëm.

Në hadith thuhet:

"Allahu (xh.sh) ia fal gjynahet robit të Tij midis dy namazeve, dy xhumave, dy umreve apo dy haxheve."

(Ahmed ibn Hanbel)

Gjithashtu, Omer ibn Hattabi (r.a) ka thënë:

"Llogarisni vetveten para se të llogariteni."

Prandaj, njeriu duhet të reflektojë: Si po e jeton jetën? Ku po e harxhon kohën dhe me kë po e kalon atë? Është shumë e rëndësishme të kesh rreth vetes shoqëri të mirë, njerëz që të ndihmojnë dhe të udhëzojnë drejt së mirës. Nëse njeriu ka shoqëri të keqe që po ia shkatërron jetën, atëherë duhet të ndryshojë ambientin dhe shoqërinë e tij.

Këtë e shohim edhe në ngjarjen e personit që kishte vrarë 99 njerëz dhe kërkoi të pendohej. Këshilla që mori nga dijetari, siç na tregon Profeti Muhamed (a.s), ishte të ndryshonte vendin dhe shoqërinë, të shkonte tek njerëz besimtarë që ia kujtonin Zotin.

Kur në fund këtë njeri e takoi vdekja, duke shkuar rrugës për fillimin e një jetë të re mbi bazat e besimit dhe pendimit, ai meritoi mëshirën e Allahut (xh.sh). (Buhari, Muslim)

Pasi njeriu reflekton mbi jetën e tij, ai duhet të fillojë ndryshimin dhe ta jetojë jetën për të kënaqur Zotin e tij. Me qëllim të sinqertë, Allahu (xh.sh) i jep sukses të madh.

Duhet të nxitohet drejt pendimit dhe kthimit tek Allahu pa vonesë, sepse jeta është e pasigurt: sot jemi, nesër mund të mos jemi.

Le të shoqërohemi me njerëz nga të cilët marrim dobi, që na kujtojnë Ahiretin dhe na këshillojnë për një jetë të drejtë, të mirë dhe të dobishme.

Merjemi - Zonja e ndershme



Shënime rreth sures Merjem

Aty nga viti i pestë i misionit profetik dhe thirrjes në Islam, krahas shtimit të numrit të besimtarëve, dita-ditës vështirësohej edhe gjendja e tyre. Në muajin Rexheb, që është muaji i shtatë i kalendarit hënor, Muhamedi a.s. këshilloi besimtarët të shpërnguleshin në Habeshe (Abisini), ku sundonte një mbret i krishterë, derisa i Madhi Zot, me Mëshirën e Vet, t'i shpëtonte. Për dy-tre muaj, numri i të shpërngulurve ose muhaxhirëve, sipas termit islam, arriti në 83 burra e 11 gra nga kurejshët mekas dhe shtatë të tjerë. Krerët kurejshët nisën një përfaqësi me Abdullah bin Ebi Rabi'ah dhe Amr bin el As që të mos u jepej mbrojtje të ikurve pasi ata kishin shkelur ligjet dhe traditat e vendit. Mbreti abisinas i dëgjoi të dy palët. Nga besimtarët foli Xhafer ibn Ebi Talib, kushëri i parë i Muhamedit a.s. Ai tregoi për gjendjen në Mekë dhe udhëzimin që u solli feja e re. Amr bin el As, i cili vite më vonë do të pushtonte Egjiptin nën flamurin islam, tha se myslimanët kishin çshenjtëruar Krishtin dhe të ëmën, Marien. Atëherë, Xhaferi r.a. shpjegoi se ata besonin Jezusin si rob të Zotit dhe të dërguarin e Tij, me mrekulli që në djep dhe se nëna e tij ishte grua e ndershme. Pastaj recitoi ajetet 1-40 të sures Merjem, shpallur pak kohë më parë. Mbreti miratoi fjalët e Kur'anit dhe u siguroi besimtarëve strehim e mbrojtje.

Profeti Zekerija (Zaharia), për të cilin flitet në ajetet e para të

sures Merjem, iu lut Zotit, në moshë të thyer, ta trashëgonte familjen e tij me një kujdestar të mirë e të pëlqyeshëm, në vazhdim të gjeneratës së Jakubit. I Madhi Zot e përgëzoi me një djalë me emrin Jahja (Gjon Baptisti), i cili vërtetoi ardhjen e Isait (Jezusit) a.s. Ky episod, së bashku me atë të Merjemit (Maries) më pas, janë ngjarjet e para biblike në Kur'an, porse ndryshojnë në përmbajtje, sepse Kur'ani erdhi si vërtetues i shkrimeve para tij, arabisht: musad-dik dhe nuk i trajton ato si kronologji e rrëfenja.

Për prejardhjen dhe jetën e Merjemit flitet në kreun e tretë, Familja e Imranit (Âli Imrân), vite më vonë, gjatë periudhës së Medines: "Kur gruaja e Imranit tha: "Zoti im, unë ta kushtova Ty atë që kam në bark. Pranoje prej meje! Ti je Dëgjuesi, Dijeploji", / - tek lindi, tha: "Zoti im, unë linda femër. - Zoti e di se ç'lindi dhe se mashkulli nuk është si femra. - E quajta Merjem dhe kërkoj për të e pasardhësit e saj mbrojtjen Tënde prej djallit të mallkuar." / Zoti i saj ia pranoi më së miri, e rriti atë më së miri dhe ia besoi Zekerijas. Sa herë hynte Zekerija tek ajo në altar, gjente ushqim. Tha: "O Merjem, nga e ke këtë?" Tha: "Nga Zoti." Zoti furnizon atë që do, pa masë." (3:35-37)

"Kur engjëjt thanë: "O Merjem, Zoti të zgjodhi ty e të dëliri, të zgjodhi ndër gratë e botës, / o Merjem, bindju Zotit tënd, përëlu dhe përkulu me ata që përkulen!" / - këto janë lajme

të panjohura që po t'i kumtojmë ty. Nuk ishte pranë tyre kur hidhnin short se kush do të kujdesej për Merjemin, nuk ishte pranë tyre kur diskutonin. / Kur engjëjt thanë: "O Merjem! Zoti të përgëzon me një fjalë prej Tij: quhet Mesih, Isa, biri i Merjemit, i shquar në këtë botë dhe ndër të afërmit në të ardhmen; / u flet njerëzve në djep dhe në moshë të pjekur është ndër të mirët", / - ajo tha: "Zoti im, si mund të kem djalë kur s'më ka prekur njeri?" Tha: "Kështu, Zoti krijon ç'të dojë. Kur vendos diçka, thotë: "Jil!" dhe ajo bëhet." (3:42-47)

Thuhet se prindërit e Maries kanë qenë Joahim dhe Hannah (Anna), e cila binte kushërirë me të shoqen e Zekerijas, ndër bijat e Imranit. Sipas traditës kristiane, Maria ishte 12 vjeçe kur hyri në Tempull, nën kujdestarinë e Zekerijas. Le t'i kthehemi tekstit të Kur'anit në suren Merjem, ajetet 16-36:

"16. Përmende në libër Merjemin kur u veçua prej njerëzve të saj në një vend nga lindja; 17. u nda prej tyre me perde dhe i dërguam Engjëllin Tonë që i shëmbëllou si njeri i pashëm. 18. Ajo tha: "Mbrohemi me të Gjithëmëshirshmin prej teje nëse i frikësohesh!" 19. Tha: "Unë jam i dërguar nga Zoti yt të të përgëzoj me një djalë të dëlirë." 20. Tha: "Si të kem djalë kur s'më ka prekur njeri dhe s'jam e pandershme?" 21. Tha: "Kështu ka thënë Zoti yt: "Për mua, kjo është e lehtë. Që ta bëjmë atë dëshmi për njerëzit dhe mëshirë prej Nesh. Është urdhër i kryer."" 22. E barti dhe u tërhoq me të diku larg. 23. I erdhën dhimbjet e lindjes pranë një trupi hurme. Tha: "Ah, sikur të kisha vdekur më parë e të isha harruar!" 24. I thirri nga poshtë: "Mos u brengos! Zoti yt ka bërë poshtë teje një rrëke. 25. Shkunde trupin e hurmës, të të bien fruta të freskëta! 26. Ha, pi e qetësohu! Po pe dikë, thuaji: "Unë i kushtova të Gjithëmëshirshmit një agjërim dhe nuk do t'i flas sot njeriu."" 27. Me atë në krah, erdhi pranë njerëzve të saj. Thanë: "O Merjem, na paske bërë diçka të padëgjuar! 28. O motër e Harunit! Yt atë nuk qe burrë i keq, as nëna jote e pandershme." 29. U bëri shenjë nga ai. Thanë: "Si mund t'i flasim një fëmijë në djep?" 30. Tha: "Unë jam rob i Zotit. Ai më dha libër e më bëri profet. 31. Më bëri të bekuar kudo që të jem dhe më urdhëroi të falem e të bëj mirësi sa të jem gjallë. 32. Të sjellshëm me nënën time, nuk më bëri kryelartë e të prapë. 33. Paqja është mbi mua ditën që u linda, ditën që do vdes dhe ditën që do të ringjallet." 34. Ai qe Isai, biri i Merjemit, fjala e vërtetë për të cilën janë në mëdyshje. 35. Zoti nuk ka nevojë për bir, lëvdur qoftë! Kur merr vendim, thotë: "Jil!"- dhe ai bëhet. 36. "Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj. Adhurojeni Atë! Kjo është rrugë e drejtë.""

"Një vend nga lindja", ajeti 16, ishte në Tempull ku ajo veçohet me perde për adhurimin e Zotit. Në këtë gjendje lartësimi shpirtëror, i erdhi Engjëlli Xhibril a.s., këtu, me emrin Rruh (Shpirt) që përmendet më së shumti në Kur'an, ndërsa asaj i shëmbëllou si njeri i pashëm dhe u tremb. I Gjithëmëshirshmi është Emri i Zotit Rrahman me të cilin arabët nënkuptonin Zotin e Gjithësisë. Me fjalën "frikësohesh", në fund të ajetit 18, arabisht: tekijj, nënkuptohet të përmbajturit e vetvetes nga veprat e këqija dhe devotshmëria ndaj Zotit, që, në fjalorin islam, quhet takva. Në ajetin 19, "djalë të dëlirë" është dhuratë nga Zoti te një femër e dëlirë dhe e virgjër siç ishte Merjemi. Në ajetin 22, për Merjemin, shfaqja në faltore e engjëllit që

një vizion, por, më vonë, ajo e kuptoi se ishte rënduar nga shtatzënia dhe u tërhoq diku (në Betlehem), larg njerëzve, për të lindur. Në gjendjen e saj, teksa i kishin ardhur dhimbjet e lindjes dhe dëshironte më mirë vdekjen se turpin, ajeti 23, nuk mund ta mblidhte mendjen e të dëgjonte. Thuhet se i foli fëmija teksa po lindte apo engjëlli. Këtu e në vazhdim është arti i përsosur i Fjalës së Zotit që ngjiz e përtërin jetën, me "rrjedhën" e gjeneratës që do të vinte dhe frytet e një jete të re që po lindte. Në ajetin 26, Meududi shpjegon se Zoti i kumtoi Merjemit të mos i fliste kujt atë ditë derisa të qetësohej e ta merrte veten. Në ajetin 28, njerëzit iu drejtuan Merjemit nga prejardhja e saj prej familjes profetike. Tashmë, Merjemi ishte e vetëdijshme për dhuratën që Krijuesi i kishte dhënë me mrekulli nga ana e Tij. Siç vërehet kudo në Kur'an, mrekullia është prej Zotit dhe Ai e shfaq atë atje ku do. Prandaj Isai a.s. tha: "Unë jam rob i Zotit." Isai a.s., si edhe profetët e tjerë, prijës e shembuj për popujt e tyre, u urdhërua të falej e të bënte mirësi (këtu: zekat), gjithashtu, të ishte i sjellshëm dhe jo kryelartë e i prapë. Në ajetin 34, Isai a.s. quhet "Isa ibn Merjem", Isa biri i Merjemit, siç thirreshin njerëzit e tjerë në emër të të atit, por që ndjekësit e tij janë në mëdyshje. I Madhi Zot është i Plotfuqishëm dhe nuk ka nevojë për krijesat e Tij (ajeti 35), as ndonjë mungesë në Qenien e Vet për të adoptuar bij a bija. Kur Zoti vendos diçka, nuk kushtëzohet, për shembull, me sakrificën e "birit të vetëm", por thotë: "Bëhu" dhe, ajo që ka vendosur Zoti, është e bërë pa vonesë. Jezu Krishti apo Isai, paqja qoftë mbi të, ajeti 36, si dhe çdo profet tjetër, u tha njerëzve: "Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, prandaj adhurojeni Atë! Kjo është rruga e drejtë."

E vërteta është e thjeshtë dhe e qartë, sikurse shprehet kudo në Kur'an. Ajo është, në të njëjtën kohë, provë e vërtetësisë së Kur'anit. Zoti thotë në Kur'an: "Mesihu, biri i Merjemit, nuk është tjetër veçse i dërguar. Para tij pati shumë të dërguar. Nëna e tij ishte e sinqertë. Që të dy hanin ushqim (si njerëzit e tjerë). Ja se si u sqarojmë argumentet, dhe shih pastaj se si i kthejnë shpinën të vërtetës!" (5:75)

Bashkë me profetët dhe popujt e tyre, Kur'ani përmend gratë, me shembull për mirë e për keq:

"Zoti u sjell shembull mohuesve gruan e Nuhit dhe gruan e Lutit. Ato ishin nën dy robërit Tanë të mirë, i tradhtuan dhe nuk u vlejti gjë ndaj Zotit, por iu tha: "Hyni me të tjerët në zjarr!" / Zoti u sjell shembull besimtarëve gruan e faraonit kur tha: "Zoti im! Ndërtomë pranë Teje një banesë në parajsë dhe shpëtomë prej faraonit dhe veprës së tij, shpëtomë nga njerëzit tiranë!" / Edhe Merjemin, bijën e Imranit, që ruajt nderin e saj. Ne i frymë nga Shpirti Ynë dhe ajo besoi në Fjalët e Zotit dhe Librat e Tij dhe ishte ndër të bindurit. (Ndalimi 66:10-12)

Sipas Tirmidhiut, studiues i njohur i traditës profetike, Ali ibn Ebi Talib r.a. ka thënë: "Dëgjova të Dërguarin e Zotit të thotë: "Më e mira e grave në kohën e saj ka qenë Merjemi, bija e Imranit dhe më e mira e grave në kohën e saj ka qenë Hadixheja, bija e Huvejlidit."

NJERIU I SHPRESËS, I MIRËSISË, I DASHURISË PËR JETËN DHE NJERIUN

*Asnjë burrë tjetër atij s'i afrohet,
Lum kush pati fatin me të të takohet.
Brumin e tij të bukur vetë lindja e tregoi,
T'bukur e pat fillimin e ashtu bukur e mbaroi...
Busajriu*

Muhamedi a.s. nuk ishte vetëm një i dërguar, si shumë të dërguar të tjerë para tij. Ai ishte profeti me të cilin Zoti i dha fund zinxhirit të profetëve. Ai ishte një njeri me të cilin Zoti nderoi dhe gradoi njerëzimin. Nëse drejtësia do të mishërohej dhe merrte formë, ajo do të merrte formën dhe pamjen e Muhamedit a.s. Nëse dëlirësia e shpirtit do të pikasej diku, padyshim do të pikasej në shpirtin e tij. Nëse virtyti do të pikturohej, nuk do të kishte tablo më optimale sesa ajo e Muhamedit a.s. Po ai ishte njeri, lëvizte në tregje dhe ushqehet si të gjithë njerëzit. Ajo që e dallonte nga të tjerët, ishte pikërisht nuri i profecisë me të cilin rrezatonte.

Pishtari i mesazhit hyjnor i ndriçonte udhën atij dhe atyre që i besonin. Fjalët e tij ishin të vërteta, veprat të drejta, udha e sigurt. Mëshira ishte bashkë me të kudo që të ishte. Bujaria kishte bujtinë shpirtin e tij. Ai i besonte lehtësimit, feja që përçoi ishte e lehtë, Kur'anë që iu shpall ishte i lehtë, tradita e tij ishte e lehtë, urdhrat dhe ndalesat të lehta. Teksa lexon biografinë e kolosëve të njerëzimit përkrah biografisë së Muhamedit a.s., të gjithë të duken të vegjël përballë tij. Kur lexon lajmet e reformatoreve përkrah lajmeve dhe jetës së tij, të gjithë shndërrohen në nxënës të Muhamedit a.s. Nëse mahnitesh me gjenitë, sapo lexon traditën profetike, të gjithë të tjerët i sheh si studentë të universitetit të Muhamedit a.s. Atë e kanë lavdëruar armiqtë përpara miqve dhe i largëti para të afërtit.

"Se ti (o Muhamed) je me virtyte madhore." (Kalem, 4)

Profeti Muhamed a.s. robëroi zemrat e njerëzve me

dhembshurinë e vet, bashkoi të përçarët me dashurinë e tij, vëllazëroi fiset me urtësinë e tij, luftoi injorancën me dije dhe kështu me lehtësi hoqi qafe vargonjtë e traditave dhe zakoneve të vjetra. Ai u dërgua me fenë e lehtësimit, me besimin e dëlirë, me natyrën e pastër, me rrugën e mesme. Ai përçoi fenë dhe ndërtoi shtetin, falej si imam dhe predikonte fenë e tij. Secili nga shokët e tij rrëfen dashurinë për Profetin a.s. sipas mënyrës së vet. Kushdo që ka biseduar me të, përshkruan ndjenjat dhe emocionet të shoqëruara me lot malli. Kushdo që e ka takuar, ka dëshmuar madhështinë e tij, pavarësisht nëse është pajtuar me të apo jo. Askush nuk mban mend ndonjë shkarje të Profetit a.s., askush nuk i ka regjistruar ndonjë gënjeshtër dhe askush nuk njeh ndonjë lapsus apo gabim të tij. Zoti ia ruajti zemrën të dëlirë, ia pastroi shpirtin, ia ruajti shikimin dhe dëgjimin. Vetë Zoti i Lartësuar e zgjodhi të dërguar për mbarë botët, mësues për të paditurit, model dhe shembull për njerëzimin. Sa më shumë lexon mbi jetën dhe biografinë e tij, aq më shumë të shtohet respekti, vlerësimi dhe nderimi për të. Prandaj ai u shndërrua në njeriun më të preferuar dhe më të dashur për të gjithë.

Ai jetoi mes shokëve të tij dhe prej tyre nxori prijës të drejtë, dijetarë të lidhur me Zotin, interpretues të Kur'anit, predikues oratorë, asketë të devotshëm dhe komandantë legjendarë. Secili nga pasuesit mori një aspekt nga jeta e Profetit a.s., prandaj ata u shndërruan në kolosë të historisë dhe uje të botës.

"Dhe ne të kemi dërguar ty (o Muhamed), si mëshirë për botët." (Enbija, 107)

Shembull ideal dhe mëshirë për njerëzimin

Në fytyrën e tij gjithmonë shihej një buzëqeshje, në ballin e tij dallohej një dritë, nga zemra e tij buronte dashuria dhe nga dora e tij rridhte bujaria. Me pak fjalë, ai ishte i bekuar në çdo mënyrë të mundshme. Edhe atëherë kur shpata i qëndronte mbi kokë në formë kërcënimi, ai nuk gëniente.

Edhe atëherë kur e joshnin me premtime për thesaret e botës, ai prapë nuk i shkeli premtimet e tij, sepse ishte i zgjedhuri i Zotit, i mbrojtur prej Tij. Ai u dërgua si shembulli ideal dhe mëshirë për gjithë njerëzimin, falës për të tjerët, i cili ua fal shkeljet dhe ua fsheh dobësitë, i cili është i përmbajtur ndaj njerëzve injorantë dhe i mëshirshëm ndaj të varfërve e të dobëtëve.

Dinjiteti i tij arrinte ato grada sa frymëzonte tek të tjerët nderim, dashuri dhe admirim.

Në portretin profetik kishte një përputhje të plotë dhe harmoni mes pamjes fizike dhe botës shpirtërore. Ishin pikërisht virtytet shpirtërore të Profetit a.s. që e renditën dhe e bënë atë më të madhin personalitet të njerëzimit.

Në kurmin e tij të pastër bashkoheshin në një vitaliteti, bujaria, ndjeshmëria e drejtësia.

Do të jenë me të në Parajsë

Theubani r.a. e donte jashtë mase Profetin a.s. dhe nuk mund ta duronte ndarjen prej tij. Një ditë kur iu afrua, fytyrën e kishte shumë të zbehtë dhe dukej shumë i trishtuar. Profeti a.s. e pyeti se si qëndronte puna dhe ai iu përgjigj: "O i dërguari i Allahut, unë nuk kam dhimbje dhe nuk jam i sëmurë, por sa herë që jam larg teje, ndihem tepër i mjeruar derisa arrij të të shoh. Për më tepër, kur kujtoj botën tjetër, unë frikësohem për shkak se ju do të ngjiteni në "Iljin" pallate madhështore me profetët. Nëse unë hyj në parajsë, do të jem në një nivel më të ulët se ju. Gjithashtu, nëse nuk hyj në parajsë, nuk do të kem kurrë mundësinë të të shoh." Më pas u shpall ajeti vijues:

"Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilët Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të singertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!" (Nisa, 69)


Ai është Profeti i të gjithëve

"O njerëz! Zoti juaj është një. Keni një origjinë. Të gjithë jeni bijtë e Ademit a.s. e Ademi është prej balte. Arabi nuk ka epërsi mbi jo-arabin, sikurse jo-arabi mbi arabin; as i bardhi mbi të ziun e as i ziu mbi të bardhin. Vlera e lartë është vetëm në takva (devotshmëri), t'i frikësohesh Allahut."

Kjo ishte thirrja e Profetit të Islamit a.s. tekrsa largohej nga kjo botë. Vetëm për umetin u mundua, e para se të nisej pyeti: "A e kreve detyrën?", ku si përgjigje i kthehet një jehonë e thellë e përlotur nga sahabët (shokët): "Po, ja Resulallah!" Pas kësaj, me një qetësi të begatë thotë:

"Dëshmo, o Zoti im!", drejtuar pafundësive.

Ai ishte Profeti i të gjithëve. Ishte përherë në përpjekje për shpëtimin e bijve të Ademit. Po edhe umeti nuk e harroi kurrë. Sa herë që kujtohet ai, zemra e besimtarit dridhet ëmbël me ngazëllim prej butësisë së begatë të qenies së tij.



Pyetje & përgjigje rreth agjërit



1. Cilat janë urtësitë dhe mirësitë e agjërimit?

Urdhrrat dhe ndalesat e Allahut patjetër që janë për të mirën e robit të tij. Është një e vërtetë e patjetërsueshme që në urdhëresat e Allahut ka dobi të mëdha dhe në të ndaluarat prej Tij ka dëme si për njeriun ashtu dhe për shoqërinë. Në fakt, jo gjithmonë njeriu ka mundur të kuptojë urtësitë e plota në lidhje me obligimet e urdhëresat e Allahut. Ka adhurime urtësitë e të cilave nuk kuptohen plotësisht nga njeriu. Ajo që i takon besimtarit është që t'i kryejë ato duke besuar se Krijuesi i Gjithësisë në çdo gjë që krijon, bën apo urdhëron ka urtësi të mëdha. Një nga adhurimet më të rëndësishme të diskutuara dhe studiuara më shumë është dhe agjërimi.

Qëllimi kryesor i adhurimit është që ta ngrejë njeriun në nivelin më të lartë të devotshmërisë. Këtë e mësojmë shprehimisht në librin plot urtësi të Allahut (xh.sh.), Kuranin Famëllartë: "O besimtarë. Ju është urdhëruar agjërimi ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat dhe të arrini devotshmërinë..." (Bekare, 2: 183-184.)

Agjërimi, duke e futur besimtarin në një edukim shpirtëror, i mundëson atij që ta çlirojë shpirtin dhe trupin nga gjynahet e mbledhura gjatë kohës. Këtu besimtari bëhet i denjë shpirtërisht të kuptojë dhe arrijë sekretin e ajetit "Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin do të shpëtojë" (Shems, 91/09). Ashtu si sadakaja dhe zekati i pastron besimtarët (Teube: 9/103), ashtu dhe zekati i trupit që është agjërimi, e shpëton njeriun nga shtypja nën sundimin e nefsit (Ibni Maxhe, Sijam, 44).

Agjëruesi duke thyer zinxhirët e nefsit kapet fort pas litarit të Allahut. Ndërkohë që nefs i duke e bërë njeriun egoist e shtyn drejt vetmisë, duke u kapur pas litarit të Allahut, njeriu kujton dhe ndjen edhe një herë se është një qenie sociale. Në shpirtin e njeriut futet thellë ndjenja e solidaritetit dhe duke u mbledhur rreth tryezave shtohet ndjenja e vëllazërisë. I pasuri falet në një rresht me të varfrin, ulet rreth një tryeze dhe duke shpërndarë fitrah e fidje i vete në ndihmë njerëzve në nevojë duke i dhënë atyre atë që Zoti u ka caktuar.

Të mirat, begatitë dhe urtësitë e agjërimit janë të shumta. Është shumë e rëndësishme që njeriu të ushqejë mirë mendjen, zemrën dhe shpirtin gjatë Ramazanit, në mënyrë që të zbërthejë në qenien e vet urtësitë e mëdha të agjërimit.

2. Për kë është farz, obligim agjërimi në muajin Ramazan?

Çdo mysliman me aftësi mendore, që ka arritur moshën e pjekurisë dhe që nuk ka pengesë për të agjëruar e ka farz agjërimit e Ramazanit.

3. Në cilat raste mund të mos agjërohet gjatë Ramazanit?

a. Udhëtimi

Lejohet mosagjërimi në rast udhëtimi. Ditët e paagjëruara duhet të shlyhen më vonë. Nëse bën

nijet të agjërosh natën, por ditën e nesërme nisësh për udhëtim, mund ta ndërprësh agjërimit nëse ke vështirësi, por e pëlqyeshme është që ai të plotësohet.

b. Sëmundja

Nëse personi ka frikë se sëmundja mund t'i shtohet apo mund t'i zgjasë më shumë, i lejohet të mos agjërojë dhe ta zëvendësojë atë pasi të shërohet. Një person të cilit mjeku i thotë që s'duhet të agjërojë dhe ai konsiderohet i sëmurë.

c. Shtatzënia dhe fëmija në gji

Nëse agjërimi i sjell dëm nënës dhe fëmijës nuk është i detyrueshëm. E njëjta vlen dhe kur nëna ka fëmijë në gji; nëse ka frikë nga pakësimi i qumështit.

d. Puna fizike e vështirë

Islami është feja e Allahut. Ai është një sistem jete perfekt dhe i balancuar. Asgjë nuk është në dëm të jetës së njeriut. Islami ka sjellë rregulla që e lumturojnë njeriun në të dy botët. Ata të cilët rrezikojnë shëndetin gjatë punës së rëndë fizike, u lejohet të mos agjërojnë, por t'i zëvendësojnë ditët e paagjëruara në ditë të tjera. Këto lehtësi mund t'i gjejmë në ajetet 183-185 të sures Bekare: "Agjërimi zgjat disa ditë, por, nëse ndonjëri prej jush është i sëmurë ose duke udhëtuar, le të agjërojë aq ditë sa i ka prishur në ditët e tjera më pas. Ata që kanë vështirësi për të agjëruar, duhet të ushqejnë si shpagim nga një të varfër për çdo ditë agjërimi. E, nëse ndonjëri jep më shumë se kaq, kjo është edhe më mirë për të. Por, agjërimi juaj është më i dobishëm, në qoftë se e dini. Muaji Ramazan është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja). Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë! Sa i përket atij që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër (le të agjërojë më vonë) aq ditë sa nuk i ka agjëruar. Allahu dëshiron që t'ju lehtësojë dhe jo që t'ju vështirësojë. Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjërimit dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjërimit), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë."

e. Plakja

Personat e thyer në moshë dhe ata që kanë sëmundje të pashërueshme lejohen të mos agjërojnë. Në vend të ditëve të paagjëruara duhet të japin fidje. Për shembull: Një i moshuar, apo i sëmurë i përhershëm që nuk ka mundësi të agjërojë duhet të japë sasi parash, apo ushqim, për 30 të varfër, apo për një të varfër për tridhjetë ditë. Në pamundësi për të gjetur të varfrin apo për të organizuar ushqimin e tij, mund të bashkëpunohet me strukturat e KMSH-së në qendër apo në rrethe. Sasia e parave për një të varfër vendoset nga institucioni fetar por logjikisht mund të përllogaritet sasia e parave të harxhuara për ushqimin ditor. Kjo e vërtetë na jepet në ajetin e mësipërm: "Ata që kanë vështirësi për të agjëruar, duhet të ushqejnë si shpagim nga një të varfër për çdo ditë agjërimi."

Këshilla të vlefshme për çdo fëmijë



Këshilla të vlefshme për çdo fëmijë
Këshillat e Lukmanit të urtë për të birin
Biri im, kalova pranë shumë
Pejgamberëve dhe përfitova prej tyre
tetë urtësi:

- Kur të jesh në namaz, ruaje zemrën
tënde.

- Kur të jesh në tubime me njerëz,
ruaje gjuhen tënde.

- Kur të jesh në shtëpitë e tyre, ruaje
shikimin tënd.

- Kur të jesh duke ngrënë, ruaje
stomakun tënd.

* Dy gjëra mos i përmend kurrë: - Të
keqen që ta bën dikush dhe të mirën që
ia bën dikujt.

* Dy gjëra mos i harro kurrë: - Allahun e
Madhëruar dhe Shtëpinë e përhershme
(ahiretin).

* Biri im, kam bartur gur dhe hekur,
mirëpo nuk kam gjetur asgjë më të
rëndë se borxhi.

* I shijova të gjitha mirësitë e nuk
shijova asgjë më të mirë se shëndeti.

* I shijova të gjitha të hidhurat e nuk
shijova asgjë më të hidhur se nevoja ime
për njerëzit.

* Biri im, me të vërtetë prindërit janë
derë prej dyerve të xhenetit, nëse ata
janë të kënaqur me ty, vazhdo për në
xhenet, e nëse janë të hidhëruar, të
është bërë perde (pengesë) për në
xhenet.

* Biri im, mos rri me njerëz të prishur
dhe mos u shoqëro me ta. Frikësohu se
po i godet dënim nga qielli e të përfshin
edhe ty.

* Biri im, rri me njerëz të dijsëm dhe
shoqërohu me ta, ndoshta zbret mbi ta
mëshirë e të përfshin edhe ty.

* Biri im, shite dynjanë për ahiretin, do
i fitosh të dyja, e mos shit ahiretin për
dynjanë, se do i humbësh të dyja.

* Biri im, mësoje gjuhën tënde që
vazhdimisht të thotë "O Allah, më fal
mua!" sepse është një çast në të cilin
Allahu nuk e refuzon duanë.

* Biri im, tek ti të ushqehen të
devotshmit, ndërsa në të gjitha çështjet
konsultohu me dijetarët.

* Biri im, mos u sill butë me injorantin,
që të mendojë se je i kënaqur me punën
e tij, dhe kujdes nga neveritja e të
mençurit, se do të kthehet ty (neveritja).

* Biri im, bëhu shërbëtor i të mirëve e
mos u bëj i dashur i të këqijve.

* Biri im, ik (largohu) nga armiku dhe
kujdes se me kë po shoqërohesh dhe
mos iu qas asaj që nuk të intereson.

* Biri im, shko në mësimet dhe tubime
me dijetarët, se me të vërtetë Allahu i
Madhëruar i ngjall zemrat me dritën e
urtësisë sikurse e ngjall tokën me shi të
furishëm.

* Biri im, shenjat e ziliqarit janë
tri: e përgojon shokun në mosprani,
kur dëshmon, bën lajka, gëzohet me
fatkeqësinë e tjetrit.

* Biri im, bëhu i pasur, do të jesh besnik.

* Biri im, dynjaja (jeta në këtë botë)
është kalimtare, prandaj kalo nëpër të e
mos u mashtro pas saj (ndërtimit në të).

* Biri im, vërtet dynjanë e ke lënë
mbrapa që kur ke ardhur në të, ndërsa
ahiretin e ke para, prandaj shtëpinë
së cilës çdo moment i afrohesh e ke
më afër se shtëpinë që çdo moment i
largohesh.

* Biri im, nëse dëshiron të zësh shok
ndonjërin, së pari hidhëroje, nëse
tregohet i drejtë në ato momente,
shoqërohu me të, përndryshe largohu
nga ai.

* Biri im, fjala e mirë dhe buzëqeshja
jote janë më të dashura te njerëzit sesa
ndihma materiale.

* Biri im, shokun vëre në atë pozitë
sikur nuk ka nevojë fare për ty, ndërsa ti
për atë çdoherë ke nevojë. * Biri im, mos
dëshiro që njerëzit të të lëvdojnë, as mos
u jep shkas që të të fyejnë, ti çdoherë
lodhu (përpiqu që t'i ndihmosh), ndërsa
të tjerët të jenë nga ti të qetë.

Hana e Ramazanit



Nga Qielli sipër, nga vendi m'i naltë,
Po zbret një hije e shenjt mbi dhe,
Si Vera q'i ngjallë lulet mbi baltë,
Shpresa shpëtimi po derdh për ne.

Po i çelin rrugn Hyjt e dashur,
Toka po i thotë mir se po vien;
Ajo ndër vedi mëshir tue pasur,
Ç'ka jan' të gjitha po i merr në prehni...

Po vjen tue fituee dritën e vetë,
Hana e Ramazanit në kët mënyrë,
"Ezani" e ftonë mbi minaret,
Zembrat për të bahen Pasqyrë...

Zembrat e mjera qi kanë mëkatë,
Tue lutun zotin ndjesë kërkajnë,
Me agjënimin ç'do dit' e natë...
Për ty o Dritë do t'o ligrojnë...

Jo, vetëm të gjallët; dru edhe gurë...
Ty po të presin me mallëgjimë,
Dhe shpirtrat e pastër qi s'edesin kurr!
Të cilët ikin me psherëtim.

Të cilët q'e lanë kët Jet' të rremë,
Tue bashkuë në përjetësië!
Qi thamë: atije ku ishim vëmë:
Ndër paq' hyjnore n'atë qetësië!...

Ti je një dritë qi derdh lumënië,
Për gjithë qaren ndër muslimanë,
Por mos harro, se në kët Shqipnië,
Djemët e tu të dun si Nanë.

Derdhe o Dritë atë begati,
Qi t'a fali Zoti për mirësië;
Neve të bindur na ke gadi,
Qi të vish ç'do Viti me mbarësië...



**2000
lekë**

Revista "Drita Islame" ka nisur abonimet për vitin 2026

- ✓ Abonimet fillojnë që nga ky muaj
- ✓ Vlera e abonimit vjetor 2000 lekë

Për ta bërë tuajën këtë revistë:

- ✓ Kontaktoni në numrin 068 87 71 655
- ✓ Drejtohuni pranë myftinive përkatëse
- ✓ Vizitoni Komunitetin Mysliman të Shqipërisë